



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 34

Tiranë – E enjte, 12 mars 2015

PËRMBAJTJA

	Page
Dekret i Presidentit nr. 8988, datë 5.3.2015	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 1565
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 112, datë 21.1.2015	Për dhënien e pensionit të posaçëm familjarëve në ngarkim të të ndjerëve Ziver Veizi, Faik Myrtaj, Hekuran Deda dhe Aleks Nika.... 1565
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 11.2.2015	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 668, datë 7.8.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me ushqim të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe për disa ndryshime në vendimin nr. 524, datë 30.7.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për masën dhe mënyrën e kompensimit të qirasë së banesës dhe të ushqimit të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”..... 1565
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 185, datë 25.2.2015	Për organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Sigurisë..... 1566
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 187, datë 4.3.2015	Për emërimin në detyrë të zëvendëskryetarit të Komisionit të Prokurimit Publik..... 1567
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 4.3.2015	Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit..... 1568
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 189, datë 4.3.2015	Për sigurimin fizik të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, të NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare..... 1578
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 190, datë 4.3.2015	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 81, datë 28.1.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për asgjësimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror””..... 1583
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 191, datë 4.3.2015	Për miratimin e Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit Publik 2015-2017..... 1584

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 192, datë 4.3.2015	Për përcaktimin e procedurave dhe kriterëve për përzgjedhjen e projekteve, organizatave apo eventeve nga Bordi i Çështjeve të Mira të Lotarisë Kombëtare.....	1603
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 193, datë 4.3.2015	Për shpalljen e zonës ekonomike, me statusin “Zonë e lirë”, në Spitallë 2, Durrës.....	1606

**DEKRET****Nr. 8988, datë 5.3.2015****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës si dhe nenit 9 pika 7, e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare” të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Arlind Afrim Ajeti
2. Naser Ismail Aliji

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani**

VENDIM**Nr. 112, datë 21.1.2015****PËR DHËNIEN E PENSIONIT TË
POSAÇËM FAMILJARËVE NË NGARKIM
TË TË NDJERËVE ZIVER VEIZI, FAIK
MYRTAJ, HEKURAN DEDA DHE ALEKS
NIKA**

Në mbështetje të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e pensionit të posaçëm familjar për personat në ngarkim të të ndjerëve Ziver Veizi, Faik Myrtaj, Hekuran Deda dhe Aleks Nika. Pensioni i posaçëm jepet për familjarët e të ndjerëve përjashtimisht nga kriteret e vendimit nr. 429, datë 12.2.2002, të Këshillit të Ministrave, “Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore”.

2. Pensioni i posaçëm familjar ose shtesa e pensionit të posaçëm shtetëror familjar, sipas rastit, të jetë deri në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë në muaj për secilën familje. Përfitues të pensionit të posaçëm familjar ose të shtesës së pensionit të posaçëm familjar janë personat në ngarkim të të ndjerit, sipas përcaktimeve në nenin 40, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Shuma e pensionit ose shtesës së pensionit të posaçëm familjar, kur kërkohet nga familjarët në ngarkim të të ndjerit, jepet e ndarë në mënyrë të barabartë për çdo përfitues.

3. Efekti financiar për vitin 2015, prej 2 400 000 (dy milionë e katërqind mijë) lekësh, dhe për vitet në vazhdim të përballohet nga buxheti i Sigurimeve Shoqërore.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrinë efektet financiare nga data 1.1.2015.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

VENDIM**Nr. 184, datë 11.2.2015****PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË VENDIMIN NR. 668, DATË 7.8.2013,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
TRAJTIMIN ME USHQIM TË
USHTARAKËVE TË FORCAVE TË
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE PËR DISA
NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 524,
DATË 30.7.2004, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MASËN DHE
MËNYRËN E KOMPENSIMIT TË
QIRASË SË BANESES DHE TË
USHQIMIT TË USHTARAKËVE TË
FORCAVE TË ARMATOSURA TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË
NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, dhe të nenit 21, të ligjit nr. 9210, datë 23.3.2004, “Për statusin e ushtarakut



të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 668, datë 7.8.2013, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pikat 1 dhe 2 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“1. Ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura, në rastet kur thirren në repart për nevoja shërbimi, ruajtjeje, gatishmërie, stërvitjeje ose fushimi, trajtohen me ushqim të gatuar, sipas normës së përcaktuar në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave.

2. Ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura, kur nuk trajtohen me ushqim të gatuar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, si dhe kur duhet të trajtohen me ushqim, por nuk kanë infrastrukturën për gatim dhe servirje ushqimi, përfitojnë kompensim në vlerë leku, si më poshtë vijon:

a) Oficerët aktivë të Forcave të Armatosura 2 000 (dy mijë) lekë në muaj;

b) nënoficerët aktivë të Forcave të Armatosura 3 000 (tre mijë) lekë në muaj;

c) ushtarët aktivë të Forcave të Armatosura 4 000 (katër mijë) lekë në muaj;”

2. Pas pikës 2 shtohet pika 2.1, me këtë përmbajtje:

“2.1 Nuk trajtohen sipas pikës 2, të këtij vendimi, ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura, të cilët trajtohen sipas vendimit nr. 546, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e pagave dhe shtesave mbi pagë të punonjësve të përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë në shtetet e huaja, të atashëve ushtarake të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe personelit civil të Ministrisë së Mbrojtjes, që shërbejnë në përfaqësitë ushtarake të Republikës së Shqipërisë pranë NATO-s, në organizatat ndërkombëtare dhe në shtabet ushtarake ndërkombëtare, të punonjësve shqiptarë për kohën që shërbejnë si nëpunës ndërlidhës pranë qendrës SECI, të punonjësve shqiptarë për kohën që shërbejnë si oficerë kontakti, pranë ministrive të brendshme homologe të shteteve të ndryshme të atashuara në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë.”.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

4. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
EDI RAMA**

VENDIM

Nr. 185, datë 25.2.2015

**PËR ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E AKADEMISË SË
SIGURISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 41, të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 37, të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme dhe të ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Organizimin e Akademisë së Sigurisë, si institucion përgjegjës i vetëm i arsimit të lartë publik policor, që ka për mision formimin, specializimin dhe kualifikimin e punonjësve të strukturave të Policisë së Shtetit, si dhe ofrimin e specializimeve dhe kualifikimeve për institucione të tjera të zbatimit të ligjit e për personat fizikë e juridikë në fushën e rendit e të sigurisë publike.

2. Akademia e Sigurisë është institucion në përbërje të Policisë së Shtetit. Ajo zhvillon veprimtarinë mësimore e kërkimore në funksion të nevojave që ka Policia e Shtetit.

3. Akademia e Sigurisë përgjigjet për:

a) Formimin bazë të punonjësve të nivelit bazë të Policisë së Shtetit;

b) përgatitjen e specialistëve të lartë të Policisë së Shtetit në të tria ciklet e studimeve universitare;

c) kualifikimin e vazhdueshëm të punonjësve të Policisë së Shtetit;

ç) zhvillimin e kërkimeve e të studimeve në fushën e policimit dhe të sigurisë;

d) ofrimin e specializimeve dhe kualifikimeve për institucione të tjera të zbatimit të ligjit dhe për personat fizikë e punonjësit e personave juridikë në fushën e rendit e të sigurisë publike.

4. Organizimi i Akademisë së Sigurisë bëhet



në përshtatje me përgjegjësitë ligjore të ngarkuara dhe llojet e programeve mësimore që ofrohen, duke u bazuar në legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë dhe për Policinë e Shtetit.

5. Njësitë kryesore të Akademisë së Sigurisë janë:

- a) Fakulteti i Sigurisë Publike;
- b) fakulteti i Hetimit të Krimit;
- c) Qendra Kërkimore Shkencore.

6. Struktura organike e Akademisë së Sigurisë miratohet nga ministri i Punëve të Brendshme me propozim të drejtorit të Policisë së Shtetit.

7. Statuti i Akademisë së Sigurisë miratohet me urdhër të përbashkët të ministrit të Punëve të Brendshme dhe të ministrit përgjegjës për arsimin.

8. Organet dhe autoritetet drejtuese të Akademisë së Sigurisë organizohen e funksionojnë në përputhje me legjislacionin në fuqi, që rregullon arsimin e lartë publik dhe organizimin e Policisë së Shtetit.

9. Akademia e Sigurisë ofron programe studimi për:

a) kualifikimin dhe specializimin e strukturave të sigurisë publike;

b) formimin, kualifikimin dhe specializimin e specialistëve në fushën e policimit dhe sigurisë në të tria ciklet e studimeve universitare;

c) kualifikimin dhe specializimin e punonjësve të agjencive të tjera të policimit, si dhe të punonjësve të personave fizikë e juridikë në fushën e rendit dhe të sigurisë publike.

10. Hapja e programeve të reja të studimeve të të gjitha cikleve, riorganizimi dhe mbyllja e tyre bëhen me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për arsimin dhe të ministrit të Punëve të Brendshme.

11. Miratimi i programeve të formimit bazë dhe i kuotave bëhet nga drejtori i Policisë së Shtetit.

12. Pranimet e studentëve në Akademinë e Sigurisë, në të gjitha programet e studimit, për ciklin e parë të studimeve, bëhen me konkurs të hapur.

13. Kohëzgjatja e programeve të studimit dhe kreditet për çdo program studimi përcaktohen në statutin e Akademisë së Sigurisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë.

14. Afatet për kualifikimet e vazhdueshme dhe ato të karrierës për të gjithë punonjësit e Policisë së Shtetit përcaktohen nga drejtori i Policisë së Shtetit.

15. Afatet për trajnimet e punonjësve të agjencive të tjera të policimit dhe subjekteve private përcaktohen në marrëveshjet përkatëse.

16. Format e studimeve që aplikohen në Akademinë e Sigurisë janë studime me kohë të plotë. Mënyrat konkrete normohen në statutin e Akademisë së Sigurisë.

17. Akademia e Policisë ka flamurin dhe stemën e vet identifikuese, të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

18. Akademia e Sigurisë është njësi shpenzuese në përbërje të programit buxhetor “Policia e Shtetit”.

19. Akademia e Sigurisë, për realizimin e përgjegjësiave të saj, bashkëpunon me institucionet e arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit, organizmat ndërkombëtarë dhe institucionet homologe të huaja, si dhe organizatat joqeveritare të interesuara në fushën e rendit e të sigurisë publike.

20. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 187, datë 4.3.2015

PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË ZËVENDËSKRYETARIT TË KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 19/2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Spiro Kuro, anëtar i Komisionit të Prokurimit Publik, emërohet zëvendëskryetar i këtij komisioni.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 188, datë 4.3.2015****PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR
SIGURIMIN E PERSONELIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 31, të ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror””, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave për sigurimin e personelit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vendimi nr. 122, datë 15.3.2001, i Këshillit të Ministrave, “Për shqyrtimin e pastërtisë dhe për dhënien e “Certifikatës së Sigurisë”, personave që do të njihen me informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror””, të ndryshuar, shfuqizohet.

3. Ngarkohen titullarët e autoriteteve verifikuese, që në mënyrë individuale, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të nxjerrin udhëzimet përkatëse për zbatimin e tij.

4. Ngarkohen ministritë, institucionet shtetërore dhe operatorët ekonomikë të interesuar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**RREGULLAT PËR SIGURIMIN E
PERSONELIT****I. OBJEKTI DHE FUSHA E VEPRIMIT****Neni 1**

Objekti i kësaj rregulloreje është:

a) përcaktimi i rregullave për zhvillimin e procedurave të verifikimit të sigurisë ndaj individëve që do të njohin, do të prodhojnë, do të ruajnë, do të administrojnë, do të transportojnë dhe do të transmetojnë informacion të klasifikuar gjatë ushtrimit të detyrave zyrtare ose në përmbushje të një veprimtarie në kuadrin e respektimit të parimit “nevojë për njohje”;

b) përcaktimi i rregullave, mbi bazën e të cilave veprohet për lëshimin, ripajisjen, refuzimin, heqjen

dhe pezullimin e “Certifikatës së sigurimit të personeli”, për edukimin e sigurisë, inspektimet dhe të drejtën e ankimimit të individëve.

Neni 2**Fusha e veprimit**

Rregullat për sigurimin e personelit zbatohen nga të gjitha ministritë, institucionet shtetërore, si dhe nga operatorët ekonomikë të interesuar për të qenë palë në kontrata të klasifikuara.

Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen në të njëjtën mënyrë ndaj të gjithë individëve që u nënshtrohen procedurave të verifikimit të sigurisë për t’u pajisur me “Certifikatë të sigurimit të personeli” për njohjen, prodhimin, ruajtjen, administrimin, transportimin dhe transmetimin e informacionit të klasifikuar gjatë ushtrimit të detyrave zyrtare ose në përmbushje të një veprimtarie në kuadrin e respektimit të parimit “nevojë për njohje”.

**II. PËRKUFIZIME DHE PARIME TË
PËRGJITHSHME****Neni 3**

Në zbatim të kësaj rregulloreje do të përdoren përkufizimet e mëposhtme:

1. “Informacion i klasifikuar” është çdo dokument ose material, pavarësisht nga forma, natyra ose mënyra e transmetimit të tij, i përgatitur ose që përgatitet, për të cilin është vendosur një nivel i caktuar klasifikimi në interes të sigurisë kombëtare dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi që kërkon mbrojtje ndaj çdo shkeljeje, shkatërrimi, përvetësimi, përhapjeje, humbjeje ose aksesit të ndonjë individi të paautorizuar dhe të çdolloj tjetër komprometimi sigurie.

2. “Autoritet i Sigurimit Kombëtar” është autoriteti i brendshëm shtetëror i një shteti përgjegjës për kontrollin dhe zbatimin e standardeve të sigurimit të informacionit të klasifikuar. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) është Autoritet i Sigurimit Kombëtar në Shqipëri.

3. “Autoritet verifikues” është Shërbimi Informativ i Shtetit (SHISH), Agjencia e Inteligjencës dhe e Sigurisë së Mbrojtjes (AISM) dhe Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në përbërje të të cilave janë ngritur njësitë strukturore të specializuara për kryerjen e verifikimeve të



sigurisë ndaj individëve që do të njohin, do të prodhojnë, do të ruajnë, do të administrojnë, do të transportojnë dhe do të transmetojnë informacion të klasifikuar.

4. “Pyetësori i sigurisë” është formulari që plotëson çdo individ që kërkon të njihet me informacion të klasifikuar dhe mbi bazën e të cilit kryhet verifikimi i sigurisë, si dhe vlerësohen të dhënat për të lëshuar ose jo “Certifikatën e sigurimit të personelit”.

5. “Nevojë për njohje” është nevoja për të pasur akses tek informacioni i klasifikuar, në kuadrin e një pozicioni të caktuar dhe me qëllim përmbushjen e një detyre specifike.

6. “Certifikata e sigurimit të personelit”, në vazhdim CSP, është dokumenti zyrtar i Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ose i një autoriteti kompetent të sigurisë së një vendi tjetër i cili vërteton nga pikëpamja e sigurisë se një individ i plotëson kushtet e përcaktuara për njohjen, ruajtjen, administrimin dhe transferimin e informacionit të klasifikuar.

7. “Brifimi”/“Debrifimi” janë tërësi instruksionesh dhe udhëzimesh sigurie lidhur me procedurat e sigurimit të informacionit të klasifikuar dhe përgjegjësitë individuale për shkeljet e rregullave të sigurisë, të cilave u nënshtrohen individët që kërkojnë të kenë mundësinë për njohje të informacionit të klasifikuar ose janë të pajisur me CSP.

8. “Shkelje sigurie” është një veprim ose mosveprim në kundërshtim me përcaktimet e legjislacionit në fuqi që rezulton ose mund të rezultojë në vjedhjen, humbjen, dëmtimin, komprometimin apo përhapjen e paautorizuar të informacionit të klasifikuar.

9. “Verifikimi i sigurisë” është tërësia e masave dhe e procedurave të aplikuara ndaj një individi, mbi bazën e të cilave do të vlerësohet lëshimi, refuzimi, pezullimi i përkohshëm ose heqja e “Certifikatës së sigurimit të personelit”.

10. “Rrezik i papranueshëm sigurie” konsiderohen rrethanat e përshkruara në këtë rregullore, në bazë të të cilave DSIK-ja refuzon dhënien e CSP-së ose vlerëson se duhet të ndërmarrë masën e heqjes ose të pezullimit të përkohshëm të saj.

11. “Rrethana të urgjencës së jashtëzakonshme” konsiderohen kushtet e pamundësisë objektive për të ndjekur procedurat normale të pajisjes me CSP,

për shkak të ushtrimit të një detyre afatshkurtër zyrtare të pjesëmarrjes në një aktivitet të paparashikuar ndërkombëtar, zgjatjes së afateve të misionëve ushtarakë në vende të ndryshme etj.

12. “Oficer sigurie”, në vazhdim OS, është punonjësi përgjegjës ose struktura e ngarkuar nga titullari i ministrisë apo i institucionit shtetëror për mbikëqyrjen dhe zbatimin e kërkesave për sigurimin e personelit dhe disiplinën e tjera të informacionit të klasifikuar.

Neni 4

Kriteret për njohjen e informacionit të klasifikuar

Kanë të drejtë të njihen, të ruajnë, të administrojnë e të transferojnë informacion të klasifikuar vetëm individët që:

a) sigurojnë të drejtën e njohjes nga titullari i ministrisë/institucionit ose Oficeri i Sigurimit Industrial i Kontraktorit për shkak të detyrës që kryejnë;

b) kanë zotësi të plotë për të vepruar;

c) janë të brifuar më parë për njohjen e procedurave të sigurisë së informacionit të klasifikuar dhe të përgjegjësive individuale për shkeljet e sigurisë;

ç) janë të pajisur me CSP, me përjashtim të rasteve për njohjen me informacionin e klasifikuar në nivelin “I kufizuar”.

Neni 5

Detyrimet e autoriteteve verifikuese dhe të institucioneve të tjera shtetërore

DSIK-ja ka të drejtë të kërkojë informacion nga autoritetet verifikuese dhe institucionet shtetërore që marrin pjesë në procesin e verifikimit lidhur me procedurat e zbatuara, të dhënat dhe dokumentacionin provues lidhur me verifikimin e rrezikut të mundshëm të sigurisë për individët që kanë aplikuar ose janë të pajisur me CSP për njohjen, ruajtjen, administrimin dhe transferimin e informacionit të klasifikuar.

Autoriteti verifikues dhe çdo strukturë shtetërore që merr kërkesën e paraqitur nga DSIK-ja për të kryer verifikimet e sigurisë ka detyrimin e kthimit të përgjigjes me shkrim së bashku me informacionin e kërkuar, sipas afateve të përcaktuara në këtë rregullore.

Ky informacion duhet të jetë i plotë, i analizuar dhe i bazuar në dokumente origjinale ose/dhe



dyshime të arsyeshme të mbështetura gjithmonë tek informacionet e vërtetuara.

Në rastet kur informacioni i përcjellë pasqyron dyshime të arsyeshme lidhur me ekzistencën e rrezikut të papranueshëm të sigurisë së informacionit të klasifikuar ndaj një personi që ka aplikuar për CSP, DSIK-ja, deri në qartësimin e plotë të situatës dhe marrjen e vendimit përkatës, përcakton një plan veprimi me masa të detyrueshme për zbatim nga autoriteti verifikues dhe institucioni shtetëror, pjesë e të cilit është aplikanti.

Procedura e parashikuar në paragrafin e katërt të këtij neni përdoret edhe në rastet kur informacioni i përcjellë pasqyron dyshime të arsyeshme lidhur me ekzistencën e rrezikut të papranueshëm të sigurisë së informacionit të klasifikuar për një person i cili është mbajtës i një CSP-je të vlefshme.

DSIK-ja dhe çdo strukturë shtetërore që merr pjesë në kryerjen e procedurave të verifikimit për pajisjen e një individi me CSP përgjigjen për ruajtjen dhe administrimin e dokumentacionit të grumbulluar, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

Neni 6

Autoritetet verifikuese dhe çdo strukturë shtetërore kanë për detyrë që gjatë angazhimit në procesin e verifikimit të sigurisë së një aplikanti:

- a) të ruajnë dinjitetin e individit që verifikohet;
- b) të respektojnë parimin e ligjshmërisë, objektivitetit, balancimit të interesave dhe të paanësisë;
- c) të angazhojnë punonjës me përvojë në kryerjen e procedurave të verifikimit;
- ç) të kryejnë verifikimin e sigurisë, sipas kriterëve të përcaktuara në këtë rregullore dhe procedurave të miratuara nga titullari i institucionit me akt të veçantë;
- d) të respektojnë afatet e verifikimit të sigurisë;
- dh) të grumbullojnë, të përpunojnë, të analizojnë dhe të dërgojnë me shkrim informacionin e kërkuar nga DSIK-ja.

Neni 7

Listat e funksioneve për njohjen e informacionit të klasifikuar

Ministritë dhe institucionet shtetërore të cilat, për shkak të veprimtarisë që kryejnë, prodhojnë informacion të klasifikuar ose gjatë bashkëpunimit me institucione të tjera e përftojnë këtë kategori

informacioni, kanë për detyrë të miratojnë dhe të dërgojnë me shkrim në DSIK:

a) listën e funksioneve organike që, për shkak të detyrave zyrtare, mund dhe duhet të njihen me informacionin e klasifikuar të prodhuar nga institucionet shtetërore ose/dhe të përfutur në kuadrin e bashkëpunimit dy-ose shumëpalësh me shtete dhe organizata ndërkombëtare;

b) listën e funksioneve organike që, për shkak të detyrave zyrtare, mund dhe duhet të njihen me informacionin e klasifikuar të NATO-s;

c) listën e funksioneve organike që, për shkak të detyrave zyrtare, mund dhe duhet të njihen me informacionin e klasifikuar të BE-së.

Kategoritë e listave të përmendura në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të këtij neni, miratohen me urdhra individualë të titullarit të institucionit, brenda 30 ditëve kalendrike nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje.

Rishikimi i këtyre listave bëhet periodikisht dhe në përputhje me ndryshimet e strukturës organike të institucionit. Dërgimi në DSIK i këtyre akteve të rishikuara kryhet jo më vonë se 30 ditë kalendrike nga data e miratimit.

III. PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË VERIFIKIMIT TË SIGURISË

Neni 8

Mënyrat e aplikimit për t'u pajisur me CSP

Mënyrat e aplikimit për të pajisur një individ me CSP janë, si më poshtë:

a) Me kërkesë të titullarëve të ministrive dhe institucioneve shtetërore ose personave të autorizuar për punonjësit dhe stafet e tyre, të kontraktuarit ose kategoritë e individëve të parashikuar për të marrë pjesë në një prokurim të klasifikuar;

b) me kërkesë të Autoritetit të Sigurimit Kombëtar të një vendi tjetër, anëtar i NATO-s, BE-së ose vend me të cilin Republika e Shqipërisë ka nënshkruar marrëveshje të përbashkët për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar;

c) me kërkesë të autoritetit kompetent të sigurisë së NATO-s, të një strukture të saj apo të BE-së;

ç) me kërkesë të drejtpërdrejtë të përfaqësuesit ligjor të një operatori ekonomik vendas, në kuadrin e procedurave për pajisje me CSI e CSP, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.



Neni 9

Verifikimi paraprak

Në rastet kur kërkesa e aplikimit për pajisje me CSP kryhet sipas kushteve të parashikuara në shkronjat “a” e “ç”, të nenit 8, titullari i ministrisë apo i institucionit shtetëror ose përfaqësuesi ligjor i një operatori ekonomik vendas marrin masa përmes OS-së, OSI-së apo strukturës së ngarkuar për kryerjen e verifikimit paraprak që konsiston në paraqitjen nga aplikanti të:

- a) dëshmisë së penalitetit;
- b) vërtetimit të gjykatës;
- c) vërtetimit të prokurorisë;
- ç) vërtetimit të zyrës së përmbartimit.

Dokumentet e verifikimit paraprak mbahen nga OS-ja, OSI-ja ose struktura e ngarkuar e institucionit shtetëror.

Ndërsa për rastet e shkronjave “b” e “c”, të nenit 8, aplikanti është i detyruar që dokumentacionin e kërkuar në funksion të verifikimit paraprak, parashikuar në shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, të këtij neni, ta dorëzojë në DSIK.

Neni 10

Dokumentacioni bazë i aplikimit për pajisje me CSP

Dokumentacioni i aplikimit për pajisje me CSP që i adresohet DSIK-së përbëhet nga:

- a) kërkesa e nënshkruar nga titullari, sipas përcaktimeve në shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, të nenit 8;
- b) pyetësori i sigurisë së aplikantit, shoqëruar me fotografinë e tij;
- c) deklaratë për ruajtjen e informacionit të klasifikuar, nënshkruar nga aplikanti;
- ç) deklaratë për dhënien e pëlqimit për mbledhjen e informacionit dhe kryerjen e verifikimeve, nënshkruar nga aplikanti;
- d) fotokopje e kartës së identitetit të aplikantit.

Modelet e dokumenteve të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, të këtij neni, përcaktohen e miratohen nga DSIK-ja.

Neni 11

Shqyrtimi fillestar

Pas paraqitjes së aplikimit për t’u pajisur me CSP, DSIK-ja ka të drejtë që, brenda 10 ditëve kalendarike, të shqyrtojë kërkesën dhe dokumentacionin bashkëlidhur dhe, kur e gjen të

bazuar në kërkesat e legjislacionit në fuqi, fillon procedurën e verifikimit të sigurisë për pajisjen me CSP.

Në rastet kur aplikimi për t’u pajisur me CSP ka mangësi, DSIK-ja e kthen praktikën e aplikimit për t’u plotësuar tek institucioni ose operatori ekonomik i interesuar, brenda afatit të përmendur në paragrafin e parë të këtij neni.

Neni 12

Kushtet për fillimin e verifikimit të sigurisë

Procedurat për verifikimin e sigurisë së personelit shërbejnë për të përcaktuar nëse një individ, duke vlerësuar besnikërinë, besueshmërinë dhe sigurinë e tij, mund të autorizohet për të njohur, ruajtur, administruar dhe transferuar informacionin e klasifikuar pa shkaktuar rrezik të papranueshëm sigurie për këto kategori informacionesh të klasifikuara.

Ky vlerësim realizohet nga DSIK-ja, bazuar në përmbajtjen e informacioneve të përfthuara nga autoritetet verifikuese dhe çdo strukturë tjetër shtetërore që angazhohet në verifikimin e sigurisë, sipas kritereve të përcaktuara në këtë rregullore.

Verifikimi i sigurisë fillon vetëm pasi individi aplikues ka pranuar dhe ka dhënë pëlqimin me shkrim që:

- a) të mblidhen të dhëna dhe të kryhen procedurat e verifikimit të sigurisë, sipas kërkesave të pyetësorit të sigurisë;
- b) të mblidhen të dhëna dhe të kryhen procedurat e verifikimit të sigurisë edhe pas pajisjes me CSP, në funksion të sqarimit të dyshimeve të bazuara në ndryshimin e gjendjes së pasqyruar në pyetësorin e sigurisë, për atë kohë sa ekzistojnë kushtet e nevojës për njohje të informacionit të klasifikuar.

Trajtimi i të dhënave personale dhe i informacioneve të grumbulluara në procesin e verifikimit të sigurisë kryhet në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Neni 13

Kërkesat e përgjithshme të vlerësimit të sigurisë

DSIK-ja, autoritetet verifikuese dhe çdo strukturë tjetër shtetërore që përfshihet në procedurat e verifikimit të sigurisë duhet t’iu përmbahen kërkesave të përgjithshme të vlerësimit të sigurisë, të cilat janë, si më poshtë:

- a) Verifikimi i saktë i identitetit, gjenealogjive



dhe statusit të shtetësisë, në të shkuarën dhe të tashmen, për çdo individ;

b) kontrolli i rekordeve në nivel lokal e kombëtar, në funksion të sigurisë kombëtare dhe të tendencave kriminale;

c) statusi financiar i aplikantit, me qëllim verifikimi, nëse ai mund të ndodhet nën presion për shkak të paqëndrueshmërisë, vështirësive serioze financiare apo të zotërimit të ndonjë pasurie të pajustificuar;

ç) informacioni për edukimin arsimor të individit pas moshës 18-vjeçare ose për periudhën e gjykuar si të përshtatshme nga autoriteti verifikues apo struktura të tjera shtetërore të përfshira në procesin e verifikimit të sigurisë;

d) informacioni për punësimin e individit duke marrë në konsideratë referencat e punëve të mëparshme, bazuar te raportet e punëdhënësve;

dh) informacioni për pjesëmarrjen në operatione ushtarake apo kohëzgjatjen e shërbimit në forcat e armatosura;

e) vlerësimi i përgjithshëm, nëse individ mund të vihet nën presion nga një forcë e huaj jomiqësore.

Neni 14

Kriteret themelore të vlerësimit të sigurisë

Kriteret themelore, mbi bazën e të cilave vlerësohet ekzistenca ose jo e rrezikut të papranueshëm të sigurisë për informacionet e klasifikuara që shërbejnë si bazë për të lëshuar, refuzuar pajisjen ose mbajtjen e mëtejshme të një CSP-je, janë rastet kur një individ rezulton se:

a) ka qenë, është ose tenton të angazhohet fshehurazi, vetëm në bashkëpunim apo në përbërje të një organizate ilegale, në veprimtari spiunazhi, terrorizmi, tradhtie, rebelimi apo dhune të armatosur ndaj rendit kushtetues apo ka nxitur aktivisht dikë të kryejë veprimtari spiunazhi, terrorizmi, tradhtie, rebelimi apo dhune të armatosur ndaj rendit kushtetues;

b) është apo ka qenë bashkëpunëtor në spiunazh, terrorizëm, tradhti, rebelim apo dhunë të armatosur ndaj rendit kushtetues, ka dyshime të ketë qenë i tillë apo bashkëpunëtor i përfaqësuesve të organizatave, shteteve të huaja, duke përfshirë këtu shërbimet e inteligjencës të cilat mund të cenojnë sigurinë e vendit tonë dhe/ose të shteteve anëtare të NATO-s, BE-së, përveç rasteve kur këto

bashkëpunime janë të autorizuar për shkak të detyrës;

c) është apo ka qenë anëtar i një organizate, e cila me mjete të dhunshme, armiqësore, të paligjshme, ka qëllim të rrëzojë qeverinë apo të ndryshojë rendin kushtetues;

ç) është apo ka qenë mbështetës i një organizate të përshtatshme si në shkronjën “c” ose është apo ka qenë i/e lidhur ngushtë me ndonjë anëtar të një organizate të tillë;

d) qëllimisht ka fshehur, ka keqprezantuar apo ka falsifikuar një informacion të një rëndësie të madhe, të një natyre sigurie të veçantë apo qëllimisht ka gënjyer gjatë plotësimit të pyetësorit të sigurisë apo intervistës së sigurisë;

dh) rezulton i dënuar për një ose më shumë vepra penale;

e) ka një historik varësie nga alkooli, përdorimi i drogave të jashtëligjshme, apo keqpërdorimi i drogave të ligjshme;

ë) ka sjellje të keqe, tendenca kriminale e përfshirje në krim të organizuar, gjë që sjell rrezikun e dobësisë përballë shantazhit apo mund të influencohet seriozisht nga presione të ndryshme;

f) me anë të veprimeve konkrete apo në mënyrë verbale ka shprehur mungesë besnikërie, besueshmërie dhe sigurie;

g) ka kryer shkelje sigurie apo në mënyrë të përsëritur ka nëpërkëmbur rregullat e sigurisë së informacionit të klasifikuar apo ka tentuar dhe ka arritur të kryejë aktivitet të paaautorizuar në sistemet e komunikimit të informacionit të klasifikuar;

gj) vuan nga çrregullime mendore kronike.

Neni 15

Shkëmbimi i drejtpërdrejtë i informacioneve ndërmjet autoriteteve verifikuese

Autoritetet verifikuese, në funksion të procedurave të verifikimit të sigurisë, janë të detyruara të shkëmbejnë në mënyrë të ndërsjellë dhe të drejtpërdrejtë informacionet që ato disponojnë për të gjitha kategoritë e individëve të punësuar apo që do të punësohen në strukturat e SHISH-it, Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme, për të cilët ata janë të ngarkuar të kryejnë apo kanë kryer verifikime sigurie, sipas legjislacionit në fuqi.

Aplikimet e adresuara në DSIK për pajisjen me CSP të punonjësve të SHISH-it, të strukturave



civile e ushtarake të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme, përveç dokumentacionit të kërkuar referuar në nenet 9 e 10, të kësaj rregulloreje, shoqërohen edhe me dokumentin e verifikimit të sigurisë, formuluar nga struktura përkatëse e cila ka kryer verifikimin e sigurisë, sipas akteve normative në fuqi.

Në këto raste, vlerësimi i sigurisë bëhet i bazuar në informacionet e shkëmbyera më parë dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë, në funksion të këtij procesi, ndërmjet Shërbimit Informativ të Shtetit, Agjencisë së Inteligjencës e Sigurisë së Mbrojtjes dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Në rastet kur një autoritet verifikues zotëron apo i dalin të dhëna që rezultojnë me rrezik të papranueshëm sigurie për një individ të pajisur me CSP, atëherë autoriteti verifikues ka detyrimin të njoftojë menjëherë DSIK-në dhe, sipas rastit, titullarin e institucionit shtetëror ku është i punësuar ky individ.

Neni 16

E drejta e DSIK-së për të kërkuar informacione sqaruese shtesë

Në rastet kur verifikimi i sigurisë për një aplikant rezulton me ekzistencën e rrezikut të papranueshëm të sigurisë, DSIK-ja ka të drejtë t'i kërkojë autoritetit verifikues informacione sqaruese shtesë, si dhe të njihet në mënyrë të drejtpërdrejtë me përmbajtjen e këtyre informacioneve.

Pas kryerjes së këtyre procedurave, analizimit të rrethanave dhe përmbajtjes së informacionit provues, DSIK-ja vendos të lëshojë, të pezullojë, të refuzojë pajisjen ose mbajtjen e mëtejshme të CSP-së për një individ të caktuar.

Në rastet kur verifikimi i sigurisë për një aplikant rezulton i pranueshëm, DSIK-ja vijon me procedurat e mëtejshme për lëshimin e CSP-së.

Neni 17

Koha që mbulon verifikimi i sigurisë

DSIK-ja u kërkon autoriteteve verifikuese dhe çdo strukture shtetërore që e gjykon të nevojshme kryerjen e verifikimeve të sigurisë, në përputhje me përcaktimet e neneve 13 e 14, të kësaj rregulloreje.

Verifikimi i sigurisë mbulon një periudhë jo më pak se 10 vitet e fundit dhe, kur kjo periudhë është e pamjaftueshme, verifikimi shtrihet nga mosha 18 vjeç deri në moshën aktuale.

Neni 18

Afatet e kryerjes së verifikimeve të sigurisë

Afati i përgjithshëm për kryerjen e procedurave të verifikimit dhe lëshimit të CSP-së nga DSIK-ja është deri në 120 ditë kalendarike. Brenda kësaj periudhe përfshihen edhe afatet e verifikimit të sigurisë nga ana e autoriteteve verifikuese.

Ky afat mund të jetë më i gjatë kur verifikimet kushtëzohen nga kryerja e procedurave në bashkëpunim me autoritetet e sigurimit kombëtar të vendeve të tjera ose kur drejtori i DSIK-së udhëzon kryerjen e verifikimeve shtesë.

Afati i përgjithshëm për kryerjen e procedurave të verifikimit fillon vetëm pas paraqitjes së plotë dhe pranimin të dokumentacionit nga ana e DSIK-së.

Autoriteti verifikues dhe çdo strukturë tjetër shtetërore, që merr kërkesën e paraqitur nga DSIK-ja për të kryer verifikimin e sigurisë, ka detyrimin të kryejë procedurat dhe të kthejë përgjigje duke dhënë informacionin e kërkuar me shkrim, jo më vonë se 45 ditë kalendarike nga data e marrjes së kërkesës.

Për raste të veçanta, me kërkesë të arsyetuar të titullarit të autoritetit verifikues dhe me miratim të drejtorit të DSIK-së, ky afat mund të zgjatet edhe 30 ditë të tjera kalendarike.

Neni 19

Rrethi i personave që verifikohen

Verifikimi i sigurisë përfshin verifikimin e aplikantit dhe të lidhjeve të ngushta të përcaktuara në shkronjat “b” e “c”, të këtij neni.

Verifikimi i sigurisë së lidhjeve të ngushta kryhet për të arritur në përfundim nëse ekziston rreziku real që aplikantit t'i bëhet presion përmes këtyre lidhjeve, të cilat, në bazë të verifikimeve të sigurisë, mund të rezultojnë të cënueshme nga shërbimet e huaja jomiqësore, grupet terroriste apo organizatat e tjera kriminale.

Verifikimi i sigurisë përfshin:

a) vetëm personin aplikues, kur kërkohet njohja me informacionin e klasifikuar, të nivelit “Konfidencial”;

b) personin aplikues, fëmijët, bashkëshortin/ bashkëshorten, bashkëjetuesin/ bashkëjetuesen, kur kërkohet njohja me informacionin e klasifikuar, të nivelit “Sekret”;

c) personin aplikues, fëmijët, bashkëshortin/-



bashkëshorten, bashkëjetuesin/bashkëjetuesen, prindërit si dhe personat e tjerë që jetojnë së bashku në të njëjtën familje kur kërkohet njohja me informacionin e klasifikuar, të nivelit “Tepër sekret”.

Neni 20

Intervista e sigurisë

Autoritetet verifikuese kanë të drejtë të kryejnë intervista me individë të cilët kanë aplikuar për t’u pajisur me CSP dhe në drejtim të tyre janë ndërmarrë procedurat e verifikimit të sigurisë.

Intervista mund të kryhet edhe me persona të tretë të paanshëm, të cilët njohin të shkuarën dhe aktivitetet e personit që i është nënshtruar verifikimit të sigurisë.

DSIK-ja interviston individë të cilët kanë aplikuar për t’u pajisur me CSP ose/dhe kërkon prej tyre paraqitjen e dokumenteve shtesë, veç atyre të përcaktuara në këtë rregullore, kur:

- a) individ aplikues kërkon të njihet me informacionin e klasifikuar të NATO-s ose BE-së;
- b) individ aplikues ka deklaruar ose rezulton se ka qenë subjekt i procedurave për azil politik, mban dyshtetësi, ka pasur ose ka shtetësi tjetër;
- c) gjatë procesit të verifikimit të sigurisë është mbledhur informacion me përmbajtje kontradiktore, me ndikim të drejtpërdrejtë në vendimmarrjen e DSIK-së për lëshimin ose jo të CSP-së.

IV. LËSHIMI, RIPAJISJA, REFUZIMI, HEQJA DHE PEZULLIMI I PËRKOHSHËM I CSP-SË. ANKIMIMI DHE RRETHANAT E JASHTËZAKONSHME

Neni 21

Nivelet e CSP-së të lëshuara nga DSIK-ja

CSP-ja lëshohet nga DSIK-ja, në përputhje me rregullat e parashikuara në një nga nivelet e mëposhtme:

- a) “Konfidencial”;
- b) “Sekret”;
- c) “Tepër sekret”.

Njohja me informacionin e klasifikuar kryhet në përputhje me nivelin e SP-së. Zotëruesi i një CSP-je me nivel më të lartë ka të drejtë që në kushtet e nevojës për njohje të ketë akses tek informacione të klasifikuara të një kategorie më të ulët.

Për individët e vendeve të tjera, CSP-ja lëshohet nga autoritetet e sigurimit kombëtar ose

çdo autoritet kompetent sigurie i vendit, shtetësinë e të cilit mban individ.

Përpara se të lëshohet CSP për një person i cili mban dy shtetësi, DSIK-ja bashkëpunon me autoritetet homologe për kryerjen e verifikimeve përkatëse.

Me kërkesë të strukturës përgjegjëse të NATO-s, BE-së apo të autoritetit të sigurimit kombëtar të një vendi tjetër, anëtar i NATO-s, BE-së ose vend me të cilin Republika e Shqipërisë ka nënshkruar marrëveshje të përbashkët për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, DSIK-ja lëshon CSP-në përkatëse kur nuk ekzistojnë rrethana që përbëjnë pengesa ligjore për lëshimin e saj.

Neni 22

Tipat e CSP-së

CSP-ja lëshohet nga DSIK-ja për njohjen, ruajtjen, administrimin apo transferimin e:

- a) informacioneve të klasifikuara të NATO-s;
- b) informacioneve të klasifikuara të BE-së;
- c) informacioneve të klasifikuara, të prodhuara nga institucionet tona shtetërore ose/dhe të përfutuara në kuadrin e bashkëpunimit dy- ose shumëpalësh me shtete dhe organizata të tjera ndërkombëtare.

Modelet për tipat e CSP-së miratohen nga DSIK-ja.

CSP-ja për njohjen, ruajtjen, administrimin apo transferimin e informacioneve të klasifikuara të NATO-s dhe të BE-së lëshohen në gjuhën angleze dhe në përputhje me kërkesat e këtyre organizatave.

Neni 23

Vlefshmëria e CSP-së

CSP-ja e lëshuar nga niveli “Konfidencial” e lart, në kushtet e kërkesave, sipas parashikimeve në shkronjat, “a”, “b”, “c”, të nenit 8, ka një afat vlefshmërie deri në 5 vite.

Ndërsa për kushtet e parashikuara në shkronjën “ç”, të nenit 8, DSIK-ja e lëshon CSP-në me një afat vlefshmërie deri në 4 vite.

Në rastet kur një individ, i cili zotëron një CSP të vlefshme, transferohet në një vend pune që sipas listës së funksioneve organike të miratuar të institucionit të ri duhet të ketë CSP, atëherë DSIK-ja, pas kërkesës së arsyetuar me shkrim të institucionit të ri, bën konfirmimin e vlefshmërisë



së CSP-së dhe modelimin e saj në përputhje me të dhënat e reja të pozicionit të punës.

Neni 24

Ndryshimi i nivelit të CSP-së

Në rastet kur një individ, i cili zotëron një CSP të një niveli më të ulët, caktohet në një funksion organik, i cili parashikon nevojën për mbajtjen e një CSP-je të një niveli më të lartë se ajo që disponon, DSIK-ja, pas kërkesës me shkrim të paraqitur nga titullari i institucionit të interesuar, nis kryerjen e procedurave shtesë të verifikimit në përputhje me referimet e nenit 19, të kësaj rregulloreje.

Afati i vlefshmërisë për CSP-në me nivelin e ndryshuar është i njëjtë me afatin që ishte parashikuar në CSP-në e nivelit më të ulët.

Neni 25

Detyrimi për njoftim

Individët e pajisur me CSP-në, përgjatë periudhës së vlefshmërisë së saj janë të detyruar të vetëdeklarojnë me shkrim, brenda 15 ditëve kalendarike, çdo ndryshim të ndodhur lidhur me kushtin e sigurisë, sipas kërkesave të listuara në pyetësonin e sigurisë.

Ky vetëdeklarim i paraqitet personit të ngarkuar ose oficerit të sigurisë, i cili e adreson për administrim e vlerësim të mëtejshëm në DSIK.

Neni 26

Ripajisja me CSP

Ripajisja me CSP kryhet nga DSIK-ja, sipas procedurave të miratuara në këtë rregullore.

Procedura për ripajisjen me CSP fillon rishtazi me aplikim nga e para.

Afati i fillimit të procedurës për ripajisjen me CSP është jo më vonë se 150 ditë kalendarike përpara se të përfundojë afati i vlefshmërisë së CSP-së ekzistuese.

Dokumentacioni i riaplikimit dorëzohet i plotë në DSIK, jo më vonë se 120 ditë kalendarike përpara se të përfundojë afati i vlefshmërisë së CSP-së ekzistuese.

Pas kryerjes së procedurave të rivefikimit dhe kur nuk ekzistojnë rrethana që përbëjnë pengesa ligjore, DSIK-ja bën ripajisjen e aplikantit me CSP.

Neni 27

Refuzimi, heqja dhe pezullimi i përkohshëm i CSP-së

DSIK-ja ka të drejtë të marrë vendim për refuzimin, heqjen ose pezullimin e përkohshëm të CSP-së, në rastet kur nëpërmjet autoriteteve verifikuese ose/dhe strukturave shtetërore të përfshira në procesin e verifikimit është përftuar informacion, sipas të cilit vlerësohet se pajisja ose mbajtja e mëtejshme e CSP-së nga një individ i caktuar përbën rrezik të papranueshëm sigurie, referuar neneve 13 e 14, të kësaj rregulloreje.

Njoftimi për vendimin e marrë nga DSIK-ja për refuzim, heqje ose pezullim të përkohshëm të CSP-së i komunikohet me shkrim titullarit të strukturës kërkuese, i cili ka të drejtë të paraqesë kërkesë me shkrim për rishqyrtimin e vendimit të marrë nga DSIK-ja.

Kjo kërkesë i adresohet titullarit të DSIK-së brenda 15 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të vendimit për refuzimin, heqjen ose pezullimin e përkohshëm të CSP-së.

Titullari i DSIK-së e shqyrton dhe vendos për kërkesën e paraqitur brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e pranimi të saj.

Në rastet e mospajimit me përgjigjen e titullarit të DSIK-së, brenda 15 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit, titullari i strukturës kërkuese ka të drejtë ta ankimojë atë me shkrim te Kryeministri.

Kryeministri, pas marrjes së ankesës, brenda 30 ditëve kalendarike, shprehet me akt të veçantë i cili është përfundimtar dhe i detyrueshëm për zbatim nga DSIK-ja dhe struktura që ka bërë ankimin.

Neni 28

Kohëzgjatja e pezullimit

Vendimi për pezullimin e CSP-së është i vlefshëm deri në momentin e shuarjes së rrethanave që përbëjnë rrezik të papranueshëm sigurie ose deri në momentin kur CSP-së i ka kaluar afati i vlefshmërisë.

Gjatë kohëzgjatjes së pezullimit të CSP-së, titullari i institucionit shtetëror dhe, sipas rastit, përfaqësuesi ligjor/administratori i operatorit ekonomik, kanë detyrim të marrin masat përkatëse për ndalimin e aksesit tek informacioni i klasifikuar për personin të cilit i është pezulluar CSP-ja.



Neni 29

Afati i riaplikimit në rastet e refuzimit apo heqjes së CSP-së

Individët, të cilëve u është refuzuar ose hequr CSP-ja, kanë të drejtë të riaplikojnë përsëri, me kusht që të ketë kaluar një vit kalendarik nga data e shkresës njoftuese për heqjen ose refuzimin e CSP-së, adresuar titullarit të aplikantit.

Neni 30

Lëshimi i CSP-së në rrethana të urgjencës së jashtëzakonshme

1. Në kushtet e rrethanave të urgjencës së jashtëzakonshme, DSIK-ja ka të drejtë të lëshojë CSP pa iu nënshtruar procedurave normale të verifikimit, kur:

a) një individ ndodhet në kushtet e ushtrimit të një detyre afatshkurtër zyrtare, për të cilën ka qenë e pamundur ndjekja e procedurave, sipas afateve kohore të parashikuara;

b) një individ ka nevojë për pjesëmarrje në një aktivitet të paparashikuar ndërkombëtar, për të cilin ka qenë e pamundur ndjekja e procedurave, sipas afateve kohore të parashikuara;

c) një individ, i cili nuk ka qenë i pajisur me CSP, ndodhet në kushtet e zgjatjes së afateve të pjesëmarrjes në misionet ushtarake, për të cilat kërkohet një CSP e vlefshme.

2. Për çdo rast të referuar në shkronjat “a”, “b”, “c”, të këtij neni, nuk duhet të ekzistojnë dyshime paraprake për mundësinë e rrezikut të papranueshëm të sigurisë. Gjithashtu, duhet të plotësohen edhe kushtet e mëposhtme:

a) Të depozitohet në DSIK një kërkesë zyrtare, ku sqarohen rrethanat e urgjencës së jashtëzakonshme dhe të pamundësisë për të aplikuar sipas procedurave normale për pajisjen me CSP, duke shpjeguar se *“nuk ekzistojnë dyshime paraprake për mundësinë e rrezikut të papranueshëm të sigurisë”*. Kjo kërkesë shoqërohet me të gjitha dokumentet e aplikimit për t’u pajisur me CSP, sipas nenit 9 dhe DSIK-ja vijon ndjekjen e procedurave të verifikimit të sigurisë.

b) Individit, për të cilin kërkohet lëshimi i CSP-së në kushtet e përcaktimeve të këtij neni, duhet të mos i jetë refuzuar me parë CSP-ja.

3. Në çdo rast, lëshimi i CSP-së në kushtet e rrethanave të urgjencës së jashtëzakonshme kryhet jo më shumë se një herë në vit dhe për një kohëzgjatje jo më shumë se 30 ditë kalendarike.

4. Niveli i CSP-së mund të jetë “Konfidencial” ose “Sekret”. Përfshihet lëshimi i CSP-së në nivelin “Tepër sekret”.

5. Në çdo rast, individ që do të pajiset me CSP në kushtet e rrethanave të urgjencës së jashtëzakonshme duhet më parë të brifohet dhe të nënshkruajë për njohjen e procedurave të sigurimit të informacionit të klasifikuar dhe të përgjegjësisë së tij individuale për shkeljet e sigurisë.

CSP-ja në kushtet e përcaktuara në këtë nen lëshohet vetëm pas depozitimit të plotë dhe të njëhershëm në DSIK të dokumenteve të kërkuara.

Neni 31

Zgjatja e afatit të CSP-së në rrethanat e urgjencës së jashtëzakonshme

Në kushtet e rrethanave të urgjencës së jashtëzakonshme, DSIK-ja ka të drejtë të zgjatë afatin e CSP-së së një individ vetëm një herë, deri në 30 ditë kalendarike gjatë ciklit të vlefshmërisë së saj, me kushtet e mëposhtme:

a) Individ, për të cilin kërkohet zgjatja e afatit, duhet të mbajë një CSP të vlefshme, lëshuar me procedurë të plotë, sipas përcaktimeve në këtë rregullore.

Përfshihen rastet e zgjatjes së afateve për një CSP e cila është e lëshuar në kushtet e rrethanave të urgjencës së jashtëzakonshme, parashikuar nga neni 30.

b) Ekziston një kërkesë zyrtare që sqaron rrethanat e urgjencës së jashtëzakonshme dhe provon rrethanat e pamundësisë për të aplikuar sipas procedurave normale për ripajisjen me CSP të re, kur:

i) një individ ndodhet në kushtet e ushtrimit të një detyre afatshkurtër zyrtare, për të cilën ka qenë e pamundur ndjekja e procedurave, sipas afateve kohore të parashikuara;

ii) një individ ka nevojë për pjesëmarrje në një aktivitet të paparashikuar ndërkombëtar, për të cilin ka qenë e pamundur ndjekja e procedurave, sipas afateve kohore të parashikuara;

iii) një individ, i cili ka qenë i pajisur me CSP, ndodhet në kushtet e zgjatjes së afateve të pjesëmarrjes në misionet ushtarake jashtë vendit dhe të pamundësisë për të aplikuar, sipas procedurave normale për ripajisjen me CSP të re.

Zgjatja e afateve të CSP-së me kushtëzimet e sipërpërmendura lejohet për CSP-në e nivelit “Konfidencial”, “Sekret” dhe “Tepër sekret”.



V. EDUKIMI ME RREGULLAT E SIGURIMIT TË PERSONELIT

Neni 32

Brifimi dhe debriefimi

Çdo individ i pajisur me CSP të vlefshme, jo më pak se një herë në vit, duhet të brifohet e të nënshkruajë përpara oficerit të sigurisë ose strukturës përgjegjëse të institucionit ku punon për njohjen e procedurave të sigurimit të informacionit të klasifikuar dhe të përgjegjëseve individuale për shkeljet e rregullave të sigurisë.

Individët e pajisur me CSP, në rastet e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës apo të ndryshimit të funksionit organik, kur nuk kërkohet mbajtja e mëtejshme e CSP-së, dorëzojnë CSP-në tek oficeri i sigurisë ose struktura përgjegjëse e institucionit ku ato punojnë dhe u nënshtrohen procedurave të debriefimit, duke nënshkruar në dokumentin përkatës. Ata janë përgjegjës për ruajtjen e informacionit të klasifikuar edhe pas ndërprerjes së marrëdhënieve të punës.

Institucionet ruajnë dhe administrojnë regjistrimet (rekordet) e individëve të brifuar dhe të debriefuar.

Neni 33

Trajnimet

DSIK-ja kryen trajnime të programuara për sigurimin e personelit që gëzon të drejtën e njohjes, ruajtjes, administrimit dhe transferimit të informacionit të klasifikuar, në kushtet e ushtrimit të detyrave zyrtare ose në përmbushje të një veprimtarie në kuadrin e respektimit të parimit “nevojë për njohje”.

Programet e trajnimit hartohen nga DSIK-ja në bashkëpunim me institucionet shtetërore dhe operatorët ekonomikë të interesuar për të qenë palë në kontrata të klasifikuara.

VI. INSPEKTIMET

Neni 34

Autoritetet verifikuese dhe çdo strukturë shtetërore që merr pjesë në procesin e verifikimit të sigurisë së një individi u nënshtrohen inspektimeve dhe mbikëqyrjes për nivelin e respektimit të kërkesave të legjislacionit në fuqi.

Drejtuesit e autoriteteve verifikuese janë të detyruar që, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e miratimit, të dërgojnë në DSIK aktet normative për procedurat e verifikimit të sigurisë që aplikojnë.

DSIK-ja informohet dhe mbikëqyr me hollësi gjithë procedurën e verifikimit të sigurisë të nisur nga autoritetet verifikuese dhe çdo strukturë tjetër shtetërore e përfshirë në këtë proces.

Neni 35

Inspektimet periodike të DSIK-së tek autoritetet verifikuese dhe strukturat e tjera shtetërore kryhen sipas programit të miratuar lidhur me aplikimin e standardeve të sigurimit të personelit, bazuar në kërkesat e parashikuara në këtë rregullore dhe në aktet normative të nxjerra nga titullarët e autoriteteve verifikuese dhe të strukturave të tjera shtetërore.

Me përjashtim të rasteve të veçanta, njoftimi dhe programi i inspektimit i dërgohen titullarit të autoritetit verifikues apo strukturës shtetërore që është parashikuar të inspektohet jo më vonë se 10 ditë kalendarike përpara datës së fillimit të inspektimit.

Autoriteti verifikues apo struktura shtetërore që do të inspektohet, përmes titullarit, ka të drejtë që brenda afatit të parashikuar në paragrafin e dytë, të këtij neni, të parashtrojë kërkesa të veçanta tek drejtori i DSIK-së lidhur me programin e inspektimit. Zgjidhja e këtyre kërkesave bëhet në mirëkuptim ndërmjet dy titullarëve, bazuar në kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Neni 36

Pas inspektimeve të kryera, DSIK-ja i adreson titullarit të autoritetit verifikues apo të strukturës shtetërore të inspektuar raportin përkatës, me rekomandimet e masave dhe afatin e fundit për korrigjimin e parregullsive e të shkeljeve të konstatuara.

Titullari i autoritetit verifikues apo i strukturës shtetërore të inspektuar, brenda 20 ditëve kalendarike nga dita e marrjes së raportit të inspektimit të DSIK-së, ka detyrimin t'i njohë strukturat dhe individët e inspektuar me detajet e raportit të inspektimit.

Titullari i autoritetit verifikues apo i strukturës shtetërore të inspektuar ka të drejtë të paraqesë në DSIK kërkesë me shkrim lidhur me rishikimin e elementeve të paraqitura në raportin e inspektimit.

DSIK-ja përgjigjet me shkrim, jo më vonë se 30 ditë kalendarike nga data e marrjes së kërkesës për rishikimin e elementeve të raportit të inspektimit.

Mospërmbushja e masave të rekomanduara dhe



e afateve të lëna për korrigjimin e parregullsive dhe të shkelleve të sigurisë të konstatuara nga raporti i inspektimit të DSIK-së përbën shkak të mjaftueshëm për aplikimin e masave administrative dhe pezullimin e përkohshëm ose heqjen e CSP-së për personat përgjegjës.

VII. DISPOZITA TË VEÇANTA

Neni 37

DSIK-ja mban, administron dhe përditëson sistemin qendror të të dhënave për të gjithë individët, ndaj të cilëve është lëshuar, refuzuar, pezulluar apo hequr CSP-ja.

Ministritë, institucionet shtetërore dhe operatorët ekonomikë të interesuar janë të detyruar të mbajnë, të administrojnë dhe të përditësojnë regjistrin e modeluar dhe të miratuar nga DSIK-ja dhe bazën elektronike të të dhënave lidhur me punonjësit dhe stafet e tyre, për të cilët është lëshuar, refuzuar, pezulluar apo hequr CSP-ja; si dhe, një herë në vit, të bëjnë rakordimet e këtyre të dhënave me sistemin qendror të të dhënave në DSIK.

Neni 38

Ministritë, institucionet shtetërore dhe operatorët ekonomikë të interesuar të marrin masa për zbatimin e kërkesave të kësaj rregulloreje.

Ngarkohet DSIK-ja për kontrollin e zbatimit të kërkesave të kësaj rregulloreje.

VENDIM

Nr. 189, datë 4.3.2015

PËR SIGURIMIN FIZIK TË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR “SEKRET SHTETËROR”, TË NATO-S, BE-SË, SHTETEVE DHE ORGANIZATAVE TË TJERA NDËRKOMBËTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 25 e 31, të ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror””, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. RREGULLA TË PËRGJITHSHME

1. Me “sigurim fizik” kuptohet tërësia e masave fizike, teknike, elektronike dhe procedurale për ruajtjen e zonave, ndërtesave, zyrave, dhomave dhe

pajisjeve ku prodhohet, regjistrohet, shfrytëzohet, transmetohet, ruhet, arkivohet dhe shkatërrohet informacioni i klasifikuar “Sekret shtetëror” i NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

2. “Zonat e sigurisë” janë hapësirat (mjediset, ambientet), ndërtesat, dhomat, zyrat, etj., ku prodhohet, regjistrohet, shfrytëzohet, transmetohet, ruhet, arkivohet dhe shkatërrohet informacioni i klasifikuar “Sekret shtetëror” i NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

3. “Perimetri i sigurisë” është kufiri fizik i një zone sigurie apo zone administrative ku ruhet apo administrohet informacioni i klasifikuar “Sekret shtetëror” i NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare në ministritë dhe institucionet shtetërore.

4. “Struktura e sigurisë/oficeri i sigurisë” janë punonjësit/nëpunësit, të cilët ndjekin dhe mbikëqyrin zbatimin e legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror” të NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare në ministritë dhe institucionet shtetërore.

5. “Vlerësimi i rrezikut dhe kërcënimi i sigurisë” është procesi periodik i identifikimit të rrezikut të sigurisë të zonave të sigurisë ku prodhohet, regjistrohet, shfrytëzohet, transmetohet, ruhet, arkivohet dhe shkatërrohet informacioni i klasifikuar “Sekret shtetëror” i NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

6. Masat e sigurimit fizik kanë për qëllim mbrojtjen e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” të NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare, nga:

- veprimtaria e shërbimeve të huaja;
- sulmet terroriste;
- vjedhja, dëmtimi, komprometimi, humbja, shkatërrimi, etj.;

- njohja nga persona të paautorizuar, të pacertifikuar, etj.;

- aksesi i personave të paautorizuar në një nivel të caktuar informacioni të klasifikuar.

7. Brenda perimetrit të hapësirave të institucionit, ku qarkullon informacioni i klasifikuar “Sekret shtetëror” i NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare, përcaktohen zonat e sigurisë.

8. Zonat e sigurisë ndahen në: Zona e Sigurisë



e Klasit të Parë, Zona e Sigurisë e Klasit të Dytë dhe Zona Administrative.

a) “Zona e Sigurisë e Klasit të Parë” është zona që ka një perimetër të mbrojtur dhe të përcaktuar qartë, ka kontrole të brendshme të rrepta dhe të përforcuara, ka të kontrolluar regjimin e hyrje-daljeve, ku lejohen vetëm personat e certifikuar përshtatshëmrisht dhe të autorizuar specifikisht për të hyrë.

Në këtë zonë prodhohet, regjistrohet, shfrytëzohet, shumëfishohet, ruhet, transmetohet dhe arkivohet informacion i klasifikuar “Sekret shtetëror” i NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare, të nivelit “Konfidencial” e lart dhe ku, si rregull, administrohet një volum i madh i këtij informacioni. Zona të Sigurisë të Klasit të Parë janë zyrat e informacionit të klasifikuar (protokoll/arkivi, kartoteka, arkivi, dhoma e serverit, shifrës), Zyra e Regjistrimit Qendror të NATO-s, Zyra e Nënregjistrimit Qendror të NATO-s, zyra e titullarit në çdo institucion shtetëror si dhe çdo objekt tjetër që, sipas specifikave të institucioneve, konsiderohet i rëndësishëm.

b) “Zona e Sigurisë e Klasit të Dytë” është zona që ka një perimetër të mbrojtur dhe të përcaktuar qartë, ka të kontrolluar regjimin e hyrje-daljeve, ku lejohen vetëm personat e certifikuar përshtatshëmrisht dhe të autorizuar specifikisht për të hyrë.

Në këtë zonë prodhohet, regjistrohet, shfrytëzohet, shumëfishohet, ruhet, transmetohet dhe arkivohet informacion i klasifikuar “Sekret shtetëror” i NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare të nivelit konfidencial e lart.

c) “Zona administrative” është zona përreth zonave të sigurisë së klasit të parë dhe të dytë, me një perimetër të caktuar, ku ekzistojnë mundësitë për monitorimin dhe kontrollin e personave dhe të mjeteve. Në këto zona administrohet vetëm informacioni i klasifikuar i nivelit “I kufizuar”.

9. Titullari i institucionit miraton, me urdhër, ndarjen e zonave të sigurisë, i cili shoqërohet me planin dhe skemën e sigurisë fizike të objektit ku mbahet e administrohet informacioni i klasifikuar “Sekret shtetëror”, i NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të

tjera ndërkombëtare, duke përcaktuar edhe regjimin e hyrje-daljeve të punonjësve e personave të tjerë në këto zona.

10. Institucionet shtetërore kanë për detyrë të marrin masa për sigurimin fizik të mjediseve ku prodhohet, regjistrohet, shfrytëzohet, transmetohet, ruhet, arkivohet dhe shkatërrohet informacioni i klasifikuar “Sekret shtetëror” i NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare. Institucionet shtetërore, brenda organikës së tyre, sipas nevojave, të caktojnë struktura të emëtuara “Strukturë sigurie apo oficerë të sigurisë” për zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e informacionit të klasifikuar.

11. Në zyrën ku administrohet informacioni i klasifikuar “Sekret shtetëror”, i NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare, duhet të ketë banakë ndarës ose rrjetë metalike për ndarjen nga mjedisi i brendshëm, dyer të blinduara me mbyllje elektronike dhe mekanike, kasaforta me mbyllje elektronike, dollapë metalikë, dritare të sigurta, pajisje kundër ndërhyrjeve të paautorizuara dhe pajisje kundër zjarrit.

12. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, në bashkëpunim me institucionet shtetërore, në mënyrë periodike, kryen dezinfektimin elektronik të ndërtesave, zyrave, dhomave, pajisjeve etj. ku prodhohet, regjistrohet, shfrytëzohet, transmetohet, ruhet, arkivohet dhe shkatërrohet informacioni i klasifikuar “Sekret shtetëror” i NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

13. Informacioni i klasifikuar regjistrohet, administrohet dhe ruhet veçmas nga informacioni i paklasifikuar.

14. Mirëmbajtja e ambienteve brenda perimetrit të zonave të sigurisë duhet të bëhet nga punonjës të certifikuar përshtatshëmrisht dhe, në çdo rast dhe gjatë gjithë kohës, nën mbikëqyrjen e personelit.

15. Në rastet kur organizohen takime apo konferenca, në të cilat trajtohet informacioni i klasifikuar i NATO-s, ndërmjet institucioneve shtetërore dhe strukturave civile ose ushtarake të NATO-s, masat e sigurimit fizik merren në përputhje me politikën e sigurisë së NATO-s, direktivat mbështetëse dhe me rregulloren për organizimin e aktiviteteve jashtë selisë së NATO-s.

16. Në rastet kur organizohen takime apo konferenca, në të cilat trajtohet informacioni i klasifikuar i BE-së, ndërmjet institucioneve



shtetërore dhe strukturave civile të BE-së, masat e sigurimit fizik merren në përputhje me legjislacionin e BE-së.

II. SIGURIMI TEKNIK

1. Informacioni i klasifikuar “Sekret shtetëror” i shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare mbahet në kasaforta apo dollapë metalike, të vendosura në ambientet brenda perimetrit të sigurisë.

Informacioni i klasifikuar i NATO-s mbahet vetëm në kasaforta të sigurta, të përshtatshme dhe të autorizuar nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.

Informacioni i klasifikuar i BE-së mbahet veçmas, në kasaforta të sigurta, të përshtatshme dhe të autorizuar nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.

Në fund të ditës së punës, dokumentet sigurohen në kasaforta apo dollapë metalike në zyrë, të vendosura në ambiente brenda zonave të sigurisë.

2. Në rastet kur punonjësi, gjatë orarit zyrtar, largohet, për arsye të ndryshme, nga ambientet e punës, informacioni i klasifikuar të sigurohet në kasaforta apo dollapë metalike.

3. Një kopje e çelësave/kodeve, ku mbahen dokumente të klasifikuara “Sekret shtetëror”, të shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare, mbahet nga eprori i drejtpërdrejtë, mbyllur në një zarf të dyllosur dhe vulosur.

Për informacionin e klasifikuar të NATO-s, një kopje e çelësave/kodeve mbahet nga titullari i institucionit.

Për informacionin e klasifikuar të BE-së, mbahet, veçmas, një kopje e çelësave/kodeve, nga titullari i institucionit.

Hapja e zarfit dhe përdorimi i çelësave dhe kodeve bëhet me urdhër të eprorit të drejtpërdrejtë dhe të titullarit të institucionit, në prani të një komisioni, jo më pak se tre anëtarësh, të ngritur prej eprorit të drejtpërdrejtë për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”, të shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare dhe të titullarit të institucionit për informacionin e klasifikuar të NATO-s dhe BE-së, për të cilët mbahet procesverbali përkatës.

4. Në ambientet ku prodhohet, regjistrohet, shfrytëzohet, transmetohet, ruhet, arkivohet dhe shkatërrohet informacioni i klasifikuar “Sekret

shtetëror” i NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare, lejohet vetëm hyrja e personave të autorizuar nga titullari i institucionit dhe certifikuar nga DSIK-ja.

5. Ndalohet futja dhe përdorimi, në ambientet ku punohet me informacionin e klasifikuar, i pajisjeve personale, të tilla si laptop, kamera, aparate fotografike, regjistruar zëri, etj.

6. Ndalohet mbajtja e furnelave elektrike, të gazit, fenerëve ndriçues me lëndë djegëse si dhe pirja e duhanit në ambientet ku punohet me informacionin e klasifikuar. Ndriçimi dhe rrjeti elektrik të vendoset sipas kërkesave të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri.

7. Institucionet shtetërore, që punojnë me informacionin e klasifikuar, janë të detyruara të marrin masa për krijimin e barrierave fizike, të cilat mbikëqyren me roja dhe mjete teknike.

8. Barrierat fizike vendosen me qëllim që:

a) të shmangin hyrjen me forcë ose të fshehtë të personave dhe të mjeteve të paautorizuara;

b) të bëjnë të mundur ndarjen e mjediseve për personelin brenda institucionit dhe futjen në zonën e sigurisë vetëm në bazë të parimit të “nevojës për t'u njohur”;

c) të zbulojnë dhe ndalojnë veprimet e personelit të pandershëm, i cili përpiqet të hyjë në informacione me nivele më të larta klasifikimi;

ç) të parandalojnë hyrjen e dukshme dhe të padukshme të personave dhe mjeteve të paautorizuara;

d) të pengojnë hyrjen në zonat e sigurisë të personave e mjeteve të paautorizuara, me qëllimin për t'u dhënë kohë për reagim forcave të sigurisë;

dh) të vendosen procedurat e kontrollit për personat dhe mjetet e autorizuar, përmes pikave të hyrjeve të caktuara.

III. SIGURIMI ME ROJË

1. Në mjediset ku punohet me informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror” të NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare është e nevojshme të merren masa për sigurimin me rojë fikse dhe/ose të lëvizshme, gjatë 24 orëve.

2. Rojat janë përgjegjëse për ruajtjen e zonave të sigurisë, ndërtesave, zyrave dhe mjediseve të tjera ku punohet me informacionin e klasifikuar që u janë dhënë për ruajtje. Ato janë përgjegjëse për sigurimin e objekteve të mësipërme edhe gjatë ditëve të pushimeve, pas orarit zyrtar të punës dhe në situata të veçanta. Rojat dhe patrullat duhet të



jenë të pajisura me certifikatë sigurie të përshtatshme.

3. Rregullat dhe vendi i shërbimit të rojave dhe patrullave përcaktohen nga autoriteti që ka në zotërim informacionin e klasifikuar.

4. Rojat dhe patrullat duhet të kenë të qarta detyrat që kryejnë dhe u bëhet instruksion i vazhdueshëm për shërbimin. Ato u nënshtrohen kontrolleve të vazhdueshme, veçanërisht pas orarit zyrtar të punës, gjatë natës dhe në situata të veçanta.

5. Rojat dhe patrullat duhet të kenë në mbikëqyrje të gjithë personat dhe mjetet që hyjnë dhe dalin nga zonat e sigurisë.

6. Në vendroje duhet të jenë të afishuara:

- Lista e personave që kanë të drejtë hyrjeje në zonat e sigurisë, ku punohet me informacionin e klasifikuar;

- Lista e institucioneve dhe numrat përkatës të telefonit që duhen thirrur në rast emergjence.

7. Rojat duhet të kenë në dispozicion mjete teknike të përshtatshme për kontrollin e personave, të mjeteve dhe të vizitorëve që kanë të drejtë të hyjnë në zonat e sigurisë. Ata kanë të drejtë të pengojnë çdo individ që lëviz në zonat e sigurisë në kundërshtim me rregullat e vendosura.

IV. SIGURIMI ELEKTRONIK

1. Sigurimi elektronik është marrja e masave për vendosjen e pajisjeve, mjeteve dhe sistemeve të sinjalizimit e kontrollit, me qëllim parandalimin e ndërhyrjes, nga persona të paautorizuar, në zonat e sigurisë dhe mjediset ku punohet me informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror” të NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

2. Institucionet shtetërore, në çdo zonë sigurie dhe në mjediset ku punohet me informacionin e klasifikuar, të marrin masa për vendosjen e pajisjeve dhe sistemeve të sigurimit elektronik si: sistem sinjalizimi kundër ndërhyrjeve të paautorizuara, sistem alarmi kundër zjarrit, sistem zbulimi me rreze infra të kuqe të lëvizjeve, sistem monitorimi të rrjetit të kamerave me qark të mbyllur, etj.

3. Monitorimi i sistemeve elektronike të sigurisë kryhet nga persona të certifikuar përshtatshëm, më parë, nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe të autorizuar nga titullari i institucionit.

4. “Struktura e sigurisë apo Oficeri i sigurisë” mbikëqyr dhe verifikon gatishmërinë e këtyre sistemeve. Në rastet e defekteve të sistemit të kontrollit elektronik riparimi i tyre bëhet në ambientet e miratuara nga titullari i institucionit, brenda zonave të sigurisë, nga persona apo kontraktorë ekonomikë, të kontraktuar për këtë qëllim, ose në mjediset e operatorëve ekonomikë, kur riparimi është i pamundur të kryhet në mjediset e institucionit, nën mbikëqyrjen e strukturës së sigurisë, sipas procedurave të parashikuara në legjislacionin në fuqi dhe të certifikuar përshtatshëm, më parë, nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.

5. Zëvendësimi apo zhvendosja e sistemeve të sigurimit elektronik të sigurisë pasqyrohet në skemën e sigurisë fizike të institucionit dhe miratohet nga titullari.

6. Regjistrimet e sistemit të sigurisë elektronike të ruhen jo më pak se 2 vjet.

V. EVAKUIMI I INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR

1. Institucionet shtetërore të marrin masa për evakuimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” të NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare, në rastet e gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme, të fatkeqësive natyrore dhe të emergjencave të tjera civile, gjatë të cilave ky informacion mund të përvetësohet, dëmtohet, komprometohet, shkatërrohet, etj.

2. Titullarët e institucioneve ku punohet me informacionin e klasifikuar miratojnë planin e detajuar të evakuimit të informacionit të klasifikuar, të shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare dhe plane të veçanta evakuimi të informacionit të klasifikuar të NATO-s dhe BE-së. Për hartimin e planeve dhe evakuimin e informacionit të klasifikuar të NATO-s dhe BE-së bashkëpunohet me Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.

3. Me shpalljen e gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme dhe emergjencave të tjera civile, gjithë personeli që administron informacion të klasifikuar ndjek situatën dhe dorëzon informacionin e klasifikuar dhe pajisjet ku prodhohet, ruhet, transmetohet, etj. në vendet dhe strukturat sipas planit të evakuimit.

Informacioni i klasifikuar i NATO-s dhe BE-së dorëzohet në DSIK, e cila merr masa për



evakuimin e këtij informacioni në destinacionin e përcaktuar.

4. Strukturat e ngarkuara për evakuim marrin masa për sistemimin e informacionit të klasifikuar të shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare në arka metalike. Në kapakun e çdo arke të vendoset:

- struktura fondkrijuese;
- viti i krijimit të këtij fondi;
- niveli më i lartë i informacionit që ndodhet në arkë.

5. Transportimi i informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” i NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare dhe pajisjeve, nga vendi i grumbullimit për në vendet e caktuara për ruajtje, bëhet me mjetet e planifikuara dhe i shoqëruar me roja të armatosura. Institucionet që nuk kanë mundësi shoqërimi me roja të armatosura bashkëpunojnë me Ministrinë e Punëve të Brendshme.

VI. DETYRAT E STRUKTURËS SË SIGURISË/OFICERIT TË SIGURISË

1. Në institucionet shtetërore ku punohet me informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror” të NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare, në varësi të volumit të informacionit të klasifikuar, krijohet Struktura e sigurisë/Oficeri i sigurisë.

2. Struktura e sigurisë/Oficeri i sigurisë është pikë kontakti i institucionit shtetëror me Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar për organizimin, koordinimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e të gjitha aspekteve ligjore dhe nënligjore për punën me informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror” të NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

3. Struktura e sigurisë/Oficeri i sigurisë, në kuadër të vlerësimit të rreziqeve dhe kërcënimeve të sigurisë, të ndjekë dinamikën e ndryshimeve të akteve normative, në zbatim të legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar.

4. Struktura e sigurisë/Oficeri i sigurisë mbikëqyr dhe inspekton, në mënyrë të vazhdueshme, punën me informacionin e klasifikuar brenda institucionit dhe i raporton titullarit të institucionit dhe, nëpërmjet tij, Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, të gjitha shkeljet dhe incidentet e sigurisë që mund të ndodhin ose kanë ndodhur për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”

të NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

5. Struktura e sigurisë/Oficeri i sigurisë i rekomandon titullarit të institucionit masat përkatëse, në rast të konstatimit të shkeljeve ose të mosmarrjes së masave për sigurimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” të NATO-s, BE-së, shteteve apo organizatave të tjera ndërkombëtare, nga strukturat e institucionit.

6. Struktura e sigurisë/Oficeri i sigurisë është strukturë përgjegjëse për trajnimet dhe edukimin për sigurinë të personelit të institucionit, i cili, për shkak të detyrave zyrtare, mund dhe duhet të njihet me kategoritë e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” të NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

7. Struktura e sigurisë/Oficeri i sigurisë ndjek dhe mbikëqyr instalimin, mirëmbajtjen dhe inspektimin e rregullave të sigurisë fizike për pajisjet e sigurimit teknik dhe elektronik në institucionin përkatës.

8. Struktura e sigurisë/Oficeri i sigurisë propozon:

- urdhrin “Për përcaktimin e zonave të sigurisë”, shoqëruar me planin e masave të sigurisë fizike dhe skemën e sigurisë fizike të objektit;
- planin e evakuimit të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” të shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare;
- planin e evakuimit të informacionit të klasifikuar të NATO-s; dhe
- planin e evakuimit të informacionit të klasifikuar të BE-së.

9. Struktura e sigurisë/Oficeri i sigurisë jep përgjigje ligjore dhe teknike për problemet në fushën e informacionit të klasifikuar si të sigurisë fizike, sigurimit të personelit, sigurimit të sistemeve të komunikimit të informacionit, sigurimit industrial, klasifikimit, administrimit, transportimit fizik, deklasifikimit, zhvlerësimit, evakuimit, asgjësimit, shkatërrimit, etj.

10. Në rastet kur në institucionin shtetëror ka sinjalizime apo vërehen sjellje e veprime, të cilat, në kuadër të vlerësimit të rreziqeve dhe kërcënimeve të sigurisë, mund të provokojnë shkelje apo incidente të sigurisë për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror” të NATO-s, BE-së, shteteve apo organizatave të tjera ndërkombëtare, i raporton



titullarit të institucionit dhe, nëpërmjet tij, Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, për:

- a) vlerësimin për rastin;
- b) masat emergjente për parandalimin e dëmit;
- c) sipas rastit, nevojën për asistencë më të specializuar nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.

11. Nëse një institucion shtetëror ka informacione të vërtetuara, të cilat, në kuadër të vlerësimit të rreziqeve dhe kërcënimeve të sigurisë, mund të përbëjnë shkelje apo incidente të sigurisë për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror” të NATO-s, BE-së, shteteve apo organizatave të tjera ndërkombëtare, i raporton titullarit të institucionit dhe, nëpërmjet tij, Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, për:

- a) vlerësimin për rastin dhe shkallën e dëmit;
- b) masat emergjente për minimizimin apo eliminimin e dëmit;
- c) sipas rastit, nevojën për asistencë më të specializuar nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.

VII. DISPOZITA TË VEÇANTA

1. Ngarkohen ministratë dhe institucionet e tjera shtetërore për zbatimin e këtij vendimi.

Drejtesit e këtyre institucioneve, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, detyrohen të nxjerrin urdhrin për përcaktimin e zonave të sigurisë, (shoqëruar me planin e masave të sigurisë fizike dhe skicën e sigurisë fizike) dhe planet e evakuimit për informacionin e klasifikuar të NATO-s dhe BE-së si dhe planin e evakuimit për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror” të shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

2. Vendimi nr. 121, datë 15.3.2001, i Këshillit të Ministrave, “Për rregullat e sigurimit fizik të informacionit të klasifikuar”, të ndryshuar, shfuqizohet.

3. Ngarkohet Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar për kontrollin e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 190, datë 4.3.2015

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 81, DATË 28.1.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE TË PROCEDURAVE PËR ASGJËSIMIN E INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR “SEKRET SHTETËROR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 25 e 31, të ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 81, datë 28.1.2008, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Kudo në vendim, fjala “... komisioni ...” zëvendësohet me “... komisionet”

2. Në pikën 1, pas fjalëve “... të komisioneve për shqyrtimin ...” shtohen “... dhe asgjësimin ...”

3. Në pikën 2 dhe kudo në vendim, pas fjalëve “... titullari i institucionit ...” shtohen “... ose i autorizuari prej tij ...”.

4. Në pikën 5, fjalët “... me përjashtim të rasteve kur informacioni bën fjalë për persona fizikë, juridikë, privatë apo publikë...” hiqen.

5. Në fund të pikës 8 shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Asgjësimi i informacionit të klasifikuar kombëtar për personat fizikë, juridikë, privatë apo publikë, të bëhet i plotë, përfshirë edhe të gjitha bazat e të dhënave që disponon institucioni (fizike apo elektronike), ku figurojnë të regjistruar. Atje ku nuk është e mundur (në regjistra ku ka të dhëna edhe për persona të tjerë, që nuk mund të asgjësohen), duhet të pasqyrohet saktësisht arsyeja e asgjësimit.”.

6. Pikat 10 dhe 17 shfuqizohen.

7. Pas pikës 19 shtohet pika 19/1, me këtë përmbajtje:

“19/1. Asgjësimi dhe shkatërrimi i informacionit të klasifikuar të BE-së bëhet në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian.”.

8. Në fund të pikës 21 shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Një kopje e këtij urdhri i dërgohet Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.”.



9. Pika 22 riformulohet, si më poshtë vijon:

“22. Drejtuesit e institucioneve shtetërore, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të nxjerrin udhëzim për zbatimin e tij, një kopje e të cilit i dërgohet DSIK-së.”.

10. Pika 23 riformulohet, si më poshtë vijon:

“23. Ngarkohet Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar për kontrollin e zbatimit të këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM Nr. 191, datë 4.3.2015

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË AFATMESME TË MENAXHIMIT TË BORXHIT PUBLIK 2015-2017

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6, të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit Publik 2015-2017, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

STRATEGJIA AFATMESME E MENAXHIMIT TË BORXHIT PUBLIK 2015- 2017

Akronime

ALL	Monedha vendase (LEK)
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
BKT	Banka Kombëtare Tregtare
BQE	Banka Qendrore Evropiane
BSH	Banka e Shqipërisë
EUR	Monedha e Bashkimit Evropian
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
KMM	Koha Mesatare në Maturim
KMR	Koha Mesatare në Rifiksim

NPL	Non Performing Loans (Kredi me performancë jo të mirë)
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
PBG	Policy Based Guarantee
pb	Pikë bazë
pp	Pikë përqindje
SAMB	Strategjia Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit
USD	Monedha kombëtare e Shteteve të Bashkuara të Amerikës
YEN	Monedha kombëtare e Japonisë
YMP	Yieldi Mesatar i Ponderuar

Fjalor teknik

Benchmark – Një instrument i tregtueshëm në frekuenca të shpeshta kohore dhe në vlera të konsiderueshme. Norma e këtij instrumenti shërben si referencë për vlerësimin e normave të instrumenteve të tjera (P.sh. bono thesari 12-mujore).

KMM (Koha mesatare në maturim) – Tregues i riskut të rifinancimit për borxhin. KMM është periudha mesatare e shprehur në vite ose në ditë që i duhet portofolit të borxhit të emetuar për t’u maturuar. Sa më larg në kohë të jetë e projektuar data e maturimit të një instrumenti, aq më i ulët është risku i rifinancimit dhe aq më e lartë është vlera e këtij treguesi. KMM për instrumentet financiarë të borxhit përllogaritet sipas formulës së mëposhtme:

$$KMM = \frac{\sum_{t \in T} t N_t}{\sum_{t \in T} N_t}$$

Nga ku:

t – data e maturimit;

T – bashkësia e të gjitha datave të maturimit;

N_t – Vlera nominale që do të paguhet në datën t.

KMR (Koha mesatare në rifiksim) – Tregues i riskut të normave të interesit për borxhin. Jep informacion lidhur me ekspozimin e portofolit të borxhit kundrejt ndryshimit të normave të interesit. KMR interpretohet si koha mesatare (në vite) që i duhet portofolit të borxhit për të ripërcaktuar normën e interesit. Sa më e madhe të jetë sasia e instrumenteve afatshkurtër dhe sasia e instrumenteve me norma interesi të ndryshueshëm në portofolin e borxhit, aq më i madh është risku i normave të interesit dhe aq më i vogël ky tregues dhe anasjelltas. Ky tregues u prezantua për herë të parë në vitin 2005 për të zëvendësuar duration, i cili është një indikator që jep informacion për



riskun e rifinancimit dhe të normave të interesit në të njëjtën kohë. KMR për instrumentet financiarë të borxhit përlllogaritet sipas formulës së mëposhtme:

$$KMR = \frac{\sum_{r \in R} r Nr + \sum_{t \in T} t Nt}{\sum_{r \in R} Nr + \sum_{t \in T} Nt}$$

Nga ku:

r- data e pagesës së kuponit të instrumentit me norma interesi të lëvizshme;

t- data e maturimit të instrumentit me norma interesi fiks;

N_r – vlera nominale e instrumentit me norma interesi të lëvizshme;

N_t – vlera nominale e instrumentit me norma interesi fiks;

R – bashkësia e të gjitha datave të maturimit për instrumente me norma interesi të lëvizshme;

T – bashkësia e të gjitha datave të maturimit për instrumente me norma interesi fiks.

PBG (*Policy base guarantee*) – Është një garanci e cila emetohet nga Banka Botërore dhe garanton pjesërisht një hua që planifikon të marrë shteti shqiptar me qëllim mundësimin e një kostoje më të favorshme se tregu.

Raport mbulimi – Raporti ndërmjet shumës së kërkuar (nga investitorët) dhe shumës së ofruar (nga shteti) në ankandet e instrumenteve financiarë shtetërorë. Shërben për të vlerësuar nivelin e plotësimit të ankandëve dhe gjendjen e likuiditetit.

Risku i kreditit – Risku që njëra nga palët që është pjesë e një transaksioni do të dështojë në përmbushjen e plotë ose të pjesshme të detyrimeve. Në këndvështrimin e menaxhimit të borxhit një risk i tillë zakonisht është prezent gjatë transaksioneve SWAP, kur shteti është mbajtës i instrumenteve financiarë ose kur ka depozita në bankat e nivelit të dytë.

Risku i kursit të këmbimit – I referohet ndikimit të lëvizjes së kursit të këmbimit të një monedhe mbi nivelin e borxhit dhe shërbimin e tij në një masë të caktuar mbi pritshmëritë.

Risku i likuiditetit – Risk i asociuar me humbjen e aftësisë së buxhetit të shtetit për të likuiduar detyrimet korrente dhe të ekzekutojë në kohë shpenzimet buxhetore. Me qëllim minimizimin e këtij risku, shteti duhet të ketë akses mbi një sasi të caktuar asetesh likuide me qëllim garantimin e fondeve në raste krizash të

përkohshme, ku gjatë të cilave bëhet e vështirë ose me kosto të lartë, sigurimi i tyre.

Risku i normave të interesit – Risku që pagesat e shërbimit të borxhit të ndryshojnë si rrjedhojë e lëvizjes së normave të interesit. Ky risk krijohet nga nevoja për të shërbyer borxhin që maturohet dhe pagesat e kuponëve të instrumenteve me norma të ndryshueshme në të ardhmen.

Risku operacional – Risku i asociuar me rritjen e koston së menaxhimit të borxhit ose me rritjen e nivelit të risqeve të tjera si rezultat i gabimeve njerëzore, prishjes së pajisjeve elektronike, dëmeve natyrore, etj.

Risku i rifinancimit – Risku i asociuar me aftësinë për të emetuar instrumente ose marrë hua me qëllim rifinancimin dhe shërbimin e borxhit aktual. Sa më i madh të jetë volumni i shumave që maturohen dhe sa më i afërt në kohë, aq më i lartë është risku i rifinancimit dhe anasjelltas. Risku i rifinancimit ndikohet nga niveli i borxhit ekzistues dhe profili i maturimeve. Rritja e maturitetit të borxhit dhe shpërndarja në kohë e maturimeve kontribuon në reduktimin e riskut të rifinancimit.

Transaksion SWAP – Marrëveshje shkëmbimi ndërmjet dy palëve, të cilat bien dakord që të shkëmbejnë flukset monetare të një instrumenti (fiks) me flukset monetare të një instrumenti tjetër me terma dhe kushte të përcaktuara në avancë. SWAP përfshihet në grupin e instrumenteve të quajtura derivativë financiarë.

Tregu primar – Tregu në të cilin emetohen për herë të parë instrumentet financiare shtetërore.

1. Parathënie

Strategjia Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit (SAMB) orienton planet e Qeverisë për financimin e borxhit në vitet e ardhshme; në rastin konkret për periudhën 2015-2017. Objektivi kyç i strategjisë është që të sigurojë realizimin e nevojave të Qeverisë për financim, si edhe nevojat për të shërbyer borxhin aktual me koston më ulët të mundshme kundrejt një shkalle të pranueshme risku. Gjithashtu, strategjia synon ruajtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të tregut primar dhe sekondar të instrumenteve financiare shtetërore.

Strategjia prezanton objektivat strategjike afatmesëm të menaxhimit të borxhit dhe instrumentet që duhen përdorur për ta implementuar, duke marrë në konsideratë zhvillimin makroekonomik dhe financiare të tregjeve.



Në linjë me dispozitat ligjore në fuqi dhe me qëllim rritjen e transparencës dhe parashikueshmërisë, Strategjia e Menaxhimit të Borxhit përditësohet dhe publikohet çdo vit nga Ministria e Financave, së bashku me objektivat e saj afatmesme dhe detajet lidhur me planin e financimit të vitit korrent.

Strategjia e Menaxhimit të Borxhit Publik 2015-2017 është kryesisht një vazhdimësi e strategjisë paraardhëse 2014-2016.

Një menaxhim i kujdesshëm dhe eficient i borxhit duhet të marrë në konsideratë profilin e maturimeve të instrumenteve të borxhit, si edhe faktorët e riskut me qëllim që të kontribuojë në qëndrueshmërinë e buxhetit dhe kuadrit makroekonomik.

Gjithashtu, implementimi i një strategjie të mirëfilltë kërkon kordinim me politikat makro-fiskale, politikat monetare, si edhe dialog ndërinstitutional me institucionet qeveritare, të cilat kanë role mbikëqyrëse.

Konsolidimi fiskal gjatë periudhës afatmesme 2015-2017 do të ishte një faktor shumë i rëndësishëm, për sa i përket realizimit me sukses të objektivave të kësaj strategjie.

SAMB (2015-2017) është në linjë me kuadrin makro-fiskal 2015-2018 duke marrë në konsideratë të ardhurat dhe shpenzimet e projektuara për këtë periudhë dhe angazhimet ndaj marrëveshjeve me partnerët ndërkombëtarë (FMN, BB, BE).

Në vitet në vijim SAMB, së bashku me reformat e tjera që janë ndërmarrë dhe do të ndërmerren nga Qeveria, do të kontribuojë në realizimin e objektivit kryesor të Qeverisë për reduktimin e nivelit të borxhit nën 60% në raport me PBB deri në fund të vitit 2019. Gjithashtu, SAMB nëpërmjet strategjive të financimit, do të synojë përmirësimin e strukturës së borxhit, indikatorëve të riskut, si edhe rritjen e qëndrueshmërisë së borxhit. Kjo do të mund të realizohet duke i dhënë frymëmarrje tregut vendas nëpërmjet shfrytëzimit të oportuniteteve që ofrojnë tregjet e huaja. Në këtë kontekst, gjatë vitit 2015 do të synohet që financimi të plotësohet në tregjet e huaja nëpërmjet instrumenteve me afat të gjatë maturimi, duke i dhënë mundësi sektorit bankar të ristrukturojë portofolin në kuadër të uljes së ekspozimit ndaj borxhit sovran dhe në të njëjtën kohë të zgjatet maturiteti i borxhit. Gjithashtu, do të menaxhohet që në tregun e brendshëm çdo vit të emetohen

shuma të konsiderueshme kryesisht drejt instrumenteve financiarë afatgjatë me qëllim krijimin e bench markeve dhe tregtimin e tyre edhe në tregjet sekondare.

SAMB për periudhën 2015-2017 krahas strategjisë bazë, ka hartuar edhe tri strategji alternative me qëllim marrjen në konsideratë të çdo eventualiteti të mundshëm, kryesisht në tregjet ndërkombëtare.

2 Objektivat e menaxhimit të borxhit

Objektivat e përgjithshëm të menaxhimit të borxhit të Qeverisë janë si më poshtë:

1. Gjatë periudhës afatmesme dhe afatgjatë, të sigurojë nevojat për financim dhe obligimet e tjera financiare me koston më të ulët të mundshme kundrejt një shkalle risku të pranueshëm.

2. Të krijojë një profil të qëndrueshëm të shërbimit të borxhit, në përputhje me kapacitetet shlyese të Qeverisë.

3. Të promovojë dhe të zhvillojë tregun primar dhe sekondar të instrumenteve financiare shtetërore.

4. Të zgjerojë bazën e investitorëve dhe të diversifikojë burimet e financimit.

2.1 Qëllimi i SAMB

Qëllimi i SAMB është që të formulojë një politikë të qartë të menaxhimit të borxhit, të paraqesë objektiva sasiorë dhe gjithashtu të zhvillojë mjete analitike për të identifikuar, monitoruar dhe zbutur risqet e portofolit.

SAMB ofron një kuadër politikash për ndërmarrjen e operacioneve të menaxhimit të detyrimeve, me qëllim minimizimin e koston së shërbimit të borxhit kundrejt një shkalle të pranueshme risku.

3. Zhvillimet e borxhit publik

3.1 Ecuria e stokut të borxhit dhe realizimi i huamarrjes

Borxhi publik i Qeverisë Qendrore në fund të muajit shtator 2014 vlerësohet të jetë 960,801 milionë lekë ose 67.95% e PBB.

Borxhi i brendshëm dhe i jashtëm janë vlerësuar përkatësisht 39.25% dhe 28.70% e PBB.


Ndërkohë, borxhi deri në fund të vitit 2014 pritet që të arrijë në nivelin 69.06% ose 71.64% në raport me PBB-në, duke marrë në konsideratë edhe detyrimet e prapambetura. Peshën më të madhe për sa i përket rritjes do ta ketë borxhi i jashtëm .




Tabela 1: Ecuria e stokut të borxhit

Në milion LEK	2010	2011	2012	2013	Shtator 2014	Dhjetor 2014 (vlerësim)
Stoku i Borxhit	715,371.01	772,516.93	827,980.79	884,692.28	960,801.24	976,472.00
I. Stoku i Borxhit Brendshëm	407,371.80	438,582.00	470,358.47	520,786.36	554,934.19	564,674.00
-shtetëror	401,821.00	429,924.80	454,695.37	500,868.36	533,820.35	538,641.00
-garantuar	5,550.80	8,657.20	15,663.10	19,918.00	21,113.84	26,033.00
II. Stoku i borxhit jashtëm	307,999.21	333,934.93	357,622.32	363,905.92	405,867.05	411,798.00
-shtetëror	268,124.46	294,275.97	319,832.52	332,499.72	376,267.73	383,291.00
-garantuar	39,874.75	39,658.96	37,789.80	31,406.20	29,599.33	28,507.00
PBB	1,239,645	1,300,624	1,335,488	1,364,782	1,413,931	1,413,931
Stoku i borxhit gjithsej/PBB	57.71%	59.40%	62.00%	64.82%	67.95%	69.06%
Stoku i borxhit të brendshëm/PBB	32.86%	33.72%	35.22%	38.16%	39.25%	39.94%
Stoku i borxhit të jashtëm/PBB	24.85%	25.67%	26.78%	26.66%	28.70%	29.12%
Stoku i borxhit gjithsej + Arrears/PBB				70.06%	71.18%	71.64%

Borxhi Qeverisjes Qëndrore në vlerë nominale



Shtesa në borxhin e Qeverisjes Qëndrore



Nga grafikët e mësipërm vërehet se borxhi gjatë vitit 2014 ka pësuar një rritje të konsiderueshme krahasuar me vitet e mëparshme. Nga 76 miliardë lekë shtesë në fund të shtatorit 2014, rreth 41 miliardë i atribuohen mbulimit të deficitit buxhetor, ndërkohë pjesa tjetër e shtesës ka ardhur si rezultat i mbështetjes buxhetore nga FMN dhe Banka Botërore në kuadër të marrëveshjes për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

Menaxhimi i borxhit, gjatë vitit 2014 ka mundur plotësimin e nevojave për huamarrje në tregun vendas. Konkretisht, në fund të muajit shtator huamarrja e brendshme ka rezultuar në 32.95 miliardë lekë ose 72% të totalit të financimit

me huamarrje të brendshme të planifikuara për vitin 2014. Ndërkohë, nëse i referohemi rishikimit të buxhetit për vitin 2014, ku nevojat për huamarrje të brendshme u rritën me 5.3 miliardë lekë, realizimi i financimit të brendshëm përlogaritet në nivelin e ri prej 65%.

Gjatë vitit 2014 rreth 78% e financimit është arritur të realizohet nëpërmjet emetimit të instrumenteve afatgjata. Huamarrja nuk është realizuar plotësisht nëpërmjet instrumenteve afatgjata, për shkak të vështirësive të hasura në treg si për shkak ristrukturimit të portofolit të bankave në kuadër të uljes së ekspozimit ndaj borxhit sovran dhe në veçanti ndaj borxhit me afat të gjatë maturimi.




Tabela 2: Financimi i deficitit sipas instrumenteve të tregut të brendshëm

Në milion LEK	Mars 2014	Qershor 2014	Shtator 2014
Financimi i deficitit	8,659.80	21,419.10	32,952.71
Instrumente financiare gjithsej	8,659.80	21,419.10	32,952.71
Bono thesari gjithsej	2,116.30	10,413.90	7,310.07
-Bono thesari lekë	2,116.30	10,413.90	8,550.93
-Bono thesari euro	0.00	0.00	-1,240.86
Obligacione gjithsej	6,543.50	11,005.20	25,642.65
Obligacione lekë	6,543.50	11,005.20	20,311.85
- Oblig.e qeverisë 2-vjeçare	1,118.90	1,846.00	-508.45
- Oblig.e qeverisë 3-vjeçare	-1,867.40	-1,170.50	-377.00
- Oblig.e qeverisë 5-vjeçare	1,329.00	-170.30	924.70
- Oblig.e qeverisë 7-vjeçare	3,963.00	6,897.70	10,562.40
- Oblig.e qeverisë 10-vjeçare	2,000.00	3,602.30	9,710.20
Obligacione euro	0.00	0.00	5,330.80

Gjatë 2 viteve të fundit financimi i deficitit është realizuar kryesisht nëpërmjet instrumenteve afatgjata duke kontribuar në përmirësimin e strukturës së borxhit dhe zgjatjes së jetëgjatësisë së tij. Gjithsesi, vlen të theksohet që portofoli mbetet ende i ekspozuar ndjeshëm ndaj riskut të rifinancimit dhe se struktura e tij kërkon përmirësime të mëtejshme në kuadër të zgjatjes së jetëgjatësisë së portofolit.

Për sa i përket financimit të huamarrjes neto sipas investitorëve, rol kryesor gjatë vitit 2014 ka luajtur Banka Kombëtare Tregtare, bankat e tjera, si edhe Fondi Prestigj, ndërkohë që është ulur ekspozimi ndaj instrumenteve shtetërore nga ana e “Raiffeisen Bank”, BSH dhe individët¹.



Për sa i përket borxhit të garantuar, gjatë vitit 2014 janë emetuar dy garanci në tregun e brendshëm në favor të KESH sh.a përkatësisht në vlerat 1 miliard lekë dhe 6 milionë euro. Ndërkohë, deri në fund të vitit pritet që garancitë e brendshme të rriten deri në nivelin e 10 miliardë lekë. Për sa i përket garancive të jashtme, gjatë vitit 2014 janë vlerësuar me ulje për shkak të nivelit të ulët të disbursimeve.

3.2 Kompozimi i portofolit të borxhit



Ky nënkapitull pasqyron mënyrën e kompozimit të borxhit të Qeverisë Qendrore në terma instrumentesh, maturiteti, valutash, si edhe ecurinë dhe zhvillimet kryesore të tregut të brendshëm dhe të jashtëm.

3.2.1 Borxhi i brendshëm

Instrumentet financiare

Në grafikët e mëposhtëm paraqitet kompozimi i portofolit të borxhit të brendshëm sipas jetëgjatësisë së instrumenteve.

¹ Realisht nuk kanë pësuar rënie, por kanë filluar të investojnë në instrumentet financiarë shtetërorë nëpërmjet fondeve të investimeve.




Nga grafikët e mësipërm vërehet që gjatë viteve të fundit është menaxhuar që të ketë një rritje në volumin e emetimeve të titujve afatgjatë. Gjatë vitit 2014 vërehet kryesisht një rritje në instrumentet me maturitet mbi 5 vite. Kjo rritje në këtë kategori instrumentesh ka ardhur kryesisht si rezultat i emetimit të suksesshëm të obligacionit 10-vjeçar, ku vetëm deri në shtator të vitit 2014 ky instrument është emetuar në vlerën e 9.7 miliardë lekë. Gjithashtu, pesha e kësaj kategorie instrumentesh ka ardhur në rritje edhe për arsye të mungesës së maturimeve në shuma të konsiderueshme. Rritja e peshës së këtij instrumenti është realizuar nëpërmjet reduktimit të peshave në kategoritë e tjera të instrumenteve

dhe kryesisht në kategorinë e instrumenteve me afat maturimi nën 1 vit. Orientimi gjatë viteve të fundit në drejtim të titujve qeveritar me afat të gjatë maturimi ka bërë që të ketë një përmirësim të dukshëm në strukturën e borxhit dhe njëkohësisht një reduktim në riskun e rifinancimit dhe likuiditetit.


Mbajtësit

Nga pikëpamja e mbajtësve të borxhit, në harkun kohor të 9 muajve borxhi i brendshëm ka pësuar një diversifikim të konsiderueshëm dhe në të njëjtën kohë është shoqëruar me një rritje të pjesëmarrësve në tregun primar të instrumenteve financiarë shtetërorë.

Mbajtësit e Borxhit Fund 2013



Mbajtësit e Borxhit Sht-2014





Eventet kryesore që kanë karakterizuar portofolin e borxhit të brendshëm, për sa u përket mbajtësve gjatë vitit 2014 janë:

- Ulja e peshës së mbajtur nga “Raiffeisen Bank” me rreth 3.4 pp, duke bërë të mundur uljen e varësisë për rifinancim nga ky investitor dhe shpërndarjen e peshës në investitorët e tjerë.


- Ulja e peshës së mbajtur nga BSH me rreth 0.86 pp duke i lënë hapësirë investitorëve të tjerë të tregut primar.

- Ulja e peshës së individëve në portofol me 0.85 pp. Realisht nuk ka pasur një rënie të interesit të individëve kundrejt instrumenteve financiare shtetërore, por rënia e peshës që përfaqësojnë individët, shpjegohet me faktin që individët kanë filluar që të përdorin si ndërmjetës fondet e investimit (Prestige Fund), të cilat ofrojnë norma më të favorshme për shkak të diversifikimit të portofolit të instrumenteve.

Diversifikimi i bazës së investitorëve ka ndikuar konsiderueshëm në zhvillimin e tregut primar vendas, por mbështetja e borxhit vendas në më shumë se 75% tek sistemi bankar dhe angazhimi i një pjese të konsiderueshme të aseteve të tij përbën risk të konsiderueshëm për ecurinë në terma afatgjatë.

Normat e interesit

Në tregun primar, normat e interesit të instrumenteve të qeverisë me maturitet deri në 2 vite kanë pësuar rënie të konsiderueshme krahasuar me fundin e vitit 2013 duke kapur kështu edhe vlerat më të ulëta historike, ndërkohë që titujt me maturitet mbi 2 vite, (përfshirë obligacionet 10-vjeçare të cilat nuk kanë pësuar asnjë ndryshim) kanë pësuar rritje. Kjo tendencë ka nisur që prej muajit janar dhe është theksuar edhe në periudhën në vazhdim.



Kërkesa dhe likuiditeti i ofruar nga pjesëmarrësit në tregun primar të titujve qeveritarë afatshkurtër ka qenë më e lartë krahasuar me titujt afatgjatë. Ndërkohë, mosrealizimi i ankandeve të obligacioneve ka krijuar presione për rritjen e normave të interesit dhe ka bërë që kurba e normave të interesit të titujve afatgjatë të shfaqet e zhvendosur lart.

Gjatë këtij viti instrumentet që kanë pësuar rënie më të madhe të normave të interesit janë bonot e thesarit 3-mujore dhe 12-mujore, normat e të cilave janë ulur përkatësisht me 48 dhe 44 pb krahasuar me fundin e vitit 2013. Ndërkohë instrumentet, normat e të cilave kanë pësuar rritje, janë obligacionet 3 dhe 7-vjeçare, përkatësisht me një rritje prej 34 dhe 22 pb. Rënia e normave të interesit për bonot e thesarit

është e lidhur me disa faktorë në tregun e instrumenteve financiarë, si p.sh:

- Shtimi i kërkesës për këto lloj instrumentesh dhe rritja e likuiditetit të sistemit bankar si rrjedhojë e ngurtësimit të kreditimit ndaj sektorit privat për shkak të rritjes së kredive që nuk performojnë mirë (NPL);

- Ulja e kërkesës së Qeverisë për huamarrje të brendshme neto krahasuar me një vit më parë;

- Ulja e normës bazë të interesit nga Banka e Shqipërisë nisur nga presionet e ulëta inflacioniste dhe vlerësimet për një kërkesë të brendshme të dobët.

Shërbimi


Shërbimi i borxhit të brendshëm në fund të vitit 2014 vlerësohet në ulje me 4.2 miliardë lekë për shkak të efektit që jep kryesisht ulja e



normave të interesit të instrumenteve afatshkurtër që janë emetuar gjatë 6-mujorit të dytë të vitit 2013 dhe në vazhdim gjatë vitit 2014. Ndërkohë, për sa i përket borxhit të jashtëm interesat e tij në shumë absolute vlerësohen me 1

miliard lekë rritje si rezultat i shtimit të disbursimeve dhe stokut të borxhit të jashtëm.

Sa më sipër edhe ripagesat e borxhit të jashtëm në fund të vitit 2014 vlerësohen në rritje me rreth 5.8 miliardë lekë.



Mbështetur në të dhënat e mësipërme dhe duke e parë edhe në vizionin afatgjatë është i rëndësishëm angazhimi për uljen e stokut të borxhit në mënyrë që të menaxhohen kostot që shoqërojnë huamarrjen.

3.3 Analiza e treguesve të riskut


Për sa u përket treguesve të riskut edhe gjatë vitit 2014 ato kanë vazhduar të kenë një trend pozitiv si rezultat i emetimit të instrumenteve afatgjatë dhe kryesisht si rezultat i emetimit të obligacionit 10-vjeçar, 3 herë brenda kësaj periudhe në një total që arrin 9.7 miliardë lekë, rreth 2.7 herë më shumë se një vit më parë.

emetimi i vazhdueshëm dhe rritja e peshës specifike të instrumenteve afatgjatë në totalin e portofolit të borxhit të brendshëm (kryesisht obligacionet 10 dhe 7-vjeçare). Yldi mesatar i ponderuar (YMP- kosto mesatare e portofolit të borxhit të brendshëm) gjithashtu ka pasur një përmirësim gjatë vitit 2014. Ky tregues ka ardhur duke u ulur nga 6.72% në fund të vitit 2013 në 5.61% në fund të muajit shtator 2014, duke përmirësuar në këtë mënyrë koston mesatare të portofolit të borxhit në tregun vendas.

Kjo ulje e Yldit mesatar të ponderuar i atribuohet likuiditetit të lartë në tregun bankar si rezultat i pasigurive të sistemit për sa i përket kreditimit të ekonomisë për shkak të rritjes së NPL-ve, si edhe uljes së normës bazë të interesit nga Banka e Shqipërisë si pjesë e politikave monetare të saj.

Pavarësisht uljes së normave të interesit, portofoli vazhdon të jetë i ndjeshëm ndaj luhatjeve të normave të interesit, për shkak të nivelit të lartë të instrumenteve të cilat duhen rifiksuar brenda një viti (rreth 72%²).

Portofoli i borxhit të brendshëm përveç ekspozimit kundrejt riskut të normave të interesit është gjithashtu i ekspozuar në masë të konsiderueshme edhe ndaj riskut të rifinancimit. Risku i rifinancimit është i asociuar me nivelin e lartë të instrumenteve të cilat maturohen brenda




Ditët mesatare në maturim (jetëgjatësia mesatare e portofolit të borxhit të brendshëm) kanë pasur një përmirësim të dukshëm gjatë këtij viti duke kapur nivelin prej 612 ditë, krahasuar me 559 ditë në fundin e vitit 2013. Kjo rritje vjen kryesisht nga

² Përfshihen edhe instrumentet me afat të shkurtër maturimi pavarësisht faktit që janë me norma intersi fikse, pasi ato rifiksohen mesatarisht çdo 0.7 herë brenda një viti



një viti. Megjithatë, ashtu sikur reflektohet edhe në treguesin e maturitetit mesatar të borxhit të brendshëm, krahasuar me një vit më parë risku i rifinancimit është relativisht më i ulët. Për ta ilustruar më qartë, më poshtë paraqitet profili i maturimeve krahasuar me fundin e vitit të kaluar.




Për sa më sipër, vlen të theksohet se ecuria e treguesve ka qenë pozitive, por qëndrueshmëria në aspektin afatgjatë mbetet ende një sfidë për tregun e brendshëm dhe zhvillimet e tij.

3.2.2 Borxhi i jashtëm

Në muajin shtator 2014 borxhi i jashtëm vlerësohet të jetë në nivelin e 2,9 miliardë euro, ku 2,7 miliardë euro është stoku i borxhit shtetëror, ndërkohë që pjesa tjetër i përket borxhit të garantuar. Për sa i përket monedhave që kompozojnë portofolin e borxhit të jashtëm, vihet re që në muajin shtator të vitit 2014 portofoli i borxhit të jashtëm është i kompozuar nga tre monedha kryesore (EUR, USD, YEN), ku peshën më të madhe e mban monedha euro me 67.75% të portofolit. Krahasuar me fundin e vitit të kaluar peshat e monedhave EUR dhe USD në portofol kanë pasur një rënie përkatësisht prej 44 dhe 10 pb. Ndërkohë, kemi një rritje të peshës së monedhës YEN me 43 pikë bazë.

Kompozimi i borxhit të jashtëm sipas monedhave



Përqindja e lartë e stokut të borxhit në euro bën që portofoli të jetë i ekspozuar ndaj riskut të kursit të këmbimit.

Në shtator të vitit 2014 efekti i shtesës në raportimin e borxhit të jashtëm (duke mbajtur si

pikë referimi kursin e fundit të vitit 2013), që vjen si rezultat i ndryshimeve në kurset e këmbimit valutor ka qenë rreth 9.6 miliardë lekë, pasi monedha vendase është zhvlerësuar kundrejt të gjitha monedhave, me përjashtim të monedhës EUR ndaj së cilës është vlerësuar. Monedha vendase është zhvlerësuar më së shumti ndaj monedhës USD dhe ky zhvlerësim ka pasur një efekt që vlerësohet rreth 3.2 miliardë lekë. Ndërkohë, efekti vetëm ndaj monedhës EUR ka qenë rreth - 513 milionë lekë³.

Gjatë nëntë muajve të vitit 2014 janë disbursuar rreth 323.5 milionë euro, nga të cilat 323 milionë i përkasin borxhit shtetëror. Krahasuar me vitet e tjera vërehet një rritje e konsiderueshme e disbursimeve, e cila i atribuohet mbështetjes buxhetore në një vlerë prej 218.7 milionë euro, ndërkohë disbursimet e projekteve me financim të huaj janë në nivele relativisht të ulëta. Disbursimet e sektorit të transportit zënë (13.4%), të ujësjellës-kanalizimeve (9.00%) dhe energjetikës (6%). Shuma e angazhuar dhe e padisbursuar është në nivele të larta rreth 800 milionë euro (pa përfshirë mbështetjen buxhetore të padisbursuar). Ky tregues kërkon vëmendje nga ministrinë e linjës lidhur me kontraktimin e projekteve të reja dhe eficiencën e projekteve ekzistuese.

Në këtë kontekst dhe për të siguruar qëndrueshmërinë e borxhit në aspektin afatgjatë bëjmë me dije se hapësira për nënshkrimin e huave të reja me kreditorë të huaj është tepër e kufizuar dhe praktikisht përbën një risk real për uljen e nivelit të borxhit publik.

Nisur nga objektivi i uljes së stokut të borxhit vëmë në dukje se:

- Hapësirat e huamarrjes në tërësi vijnë duke u ulur në harkun kohor 2015-2017 dhe arrijnë nivele tepër të ulëta në periudhën afatgjatë 2018-2020.

- Hapësira për huamarrjen e jashtme, e cila është në përputhje me marrëveshjet e nënshkruara dhe ato në vijim, qëndron relativisht e lartë në periudhën 2014-2016 për shkak të mbështetjes buxhetore për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

³ Shenja negative i referohet pakësimit të stokut të borxhit të jashtëm kur raportohet në monedhën vendase për shkak të zhvlerësimit të monedhës EUR kundrejt LEK



- Hapësirat për huamarrje të brendshme ulen ndjeshëm duke ndikuar në këtë mënyrë në më pak burime për financimin e investimeve të brendshme. Për vitet 2016-2017, hapësirat për huamarrje të brendshme vijnë duke u ulur në nivelin rreth 10 miliardë lekë, ndërkohë që në vitet në vijim ka vetëm maturim të instrumenteve të brendshme në nivele të konsiderueshme.

Për sa më sipër menaxhimi i borxhit sugjeron përfshirjen në kuadrin makro të treguesve të borxhit të jashtëm për të gjithë ekonominë (duke përfshirë edhe sektorin energjetik), si dhe vlerësimin e angazhimeve të financimeve të projekteve të huaja për një huamarrje të huaj të kujdesshme dhe brenda parametrave të vendosura për këtë qëllim.

Gjatë vitit 2015 pritet që të ketë një qëndrueshmëri të normave të interesit për instrumentet financiarë shtetërorë me afat të shkurtër maturimi. Ndërkohë pritet që të ketë rritje në segmentin e instrumenteve afatgjatë, për shkak të ristrukturimit të portofolit të investitorëve (kryesisht sektori bankar) dhe orientimit drejt instrumenteve afatshkurtër, në kuadër të uljes së ekspozimit ndaj riskut dhe direktivave nga bankat mëma. Për sa i përket huazimit në monedhën euro pritet që të jetë përafërsisht po aq i kushtueshëm sa edhe gjatë vitit 2014 pasi parashikimet flasin për një qëndrueshmëri ose ulje të normës bazë të interesit nga BQE me qëllim lehtësimin e kreditimit dhe rritjen e likuiditetit të sistemit bankar europian.

Pavarësisht pritshmërive për vitin 2015, menaxhimi i borxhit publik në periudhën afatmesme me qëllim minimizimin e riskut të normave të interesit do të synoj ta orientoj borxhin më shumë drejt instrumenteve që ofrojnë norma të favorshme dhe njëkohësisht të ruaj të pacenuar objektivin për rritjen e jetëgjatësisë së borxhit. Gjithashtu, do të synohet që instrumentet afatgjatë me norma interesi të ndryshueshme të qëndrojnë në nivelin e 15-17 % të portofolit të borxhit të brendshëm.

Për sa i përket riskut të kursit të këmbimit vihet re që portofoli i borxhit të jashtëm është vulnerabel ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit, veçanërisht kundrejt luhatjeve të monedhës euro pasi më shumë se 65% e portofolit të borxhit të jashtëm është i denominuar në këtë monedhë.

Zhvlerësimi i monedhës kombëtare kundrejt monedhës euro dhe monedhave të tjera që zënë peshë të rëndësishme në portofolin e borxhit të jashtëm mund të ndikojë mbi buxhetin duke rritur koston e shërbimit të borxhit, por edhe duke rritur nivelin e tij.

Për sa më sipër, dhe për të menaxhuar ekspozimin ndaj këtij risku menaxhimi i borxhit publik, ka menduar që në periudhën afatmesme ta mbaj nivelin e borxhit të jashtëm në nivele jo më të larta se 45%.

4 Objektivat dhe supozimet e Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit

4.1 Objektiva dhe udhëzime lidhur me huamarrjen

Strategjia e Menaxhimit të Borxhit me qëllim uljen e risqeve të portofolit të borxhit në periudhën afatmesme dhe afatgjatë ka vendosur disa objektiva dhe udhëzime lidhur me huamarrjen, të cilat janë:

Në tregun vendas:

- Me qëllim mbajtjen nën kontroll dhe përmirësimin e profilit të maturimeve, synohet që sigurimi i huamarrjes së re të realizohet nëpërmjet instrumenteve afatgjatë dhe në rastet kur financimi i brendshëm është në vlera të ulëta të ketë zëvendësim të instrumenteve afatshkurtër me ato afatgjata.

- Rishpërndarja e peshave të instrumenteve të brendshme në mënyrë të njëtrajtshme, qoftë edhe brenda të njëjtut tip instrumenti, duke maturuar në ankandet ku vlerat janë të larta dhe duke shtuar emetimin atje ku vlerat janë të ulëta.⁴

- Politika të emetimit të instrumenteve me qëllim krijimin e *benchmark*-ve për instrumentet afatgjatë.

- Realizimi i reformave të nevojshme për zhvillimin, rritjen e likuiditetit në tregut sekondar, si edhe zgjerimin e bazës së investitorëve.

Në tregun e huaj:

- Sigurimi i fondeve të nevojshme për rifinancimin e Eurobondit në vlerën prej 300 milionë euro me kosto sa më të favorshme.

- Emetimi i garancisë pjesore (PBG) me qëllim uljen e huamarrjes së brendshme për të lehtësuar kreditimin e sektorit privat.

- Sigurimi i huamarrjes së huaj duke u bazuar

⁴Një menaxhim portofoli i kësaj natyre mund të sjellë përfitime duke ushtruar presion për rënien e normave të interesit dhe njëkohësisht të ul riskun e likuiditetit.



në financimet e pritshme të projekteve dhe duke u plotësuar me sigurimin e financimit nga jashtë në përputhje të marrëveshjes me FMN-në dhe Bankën Botërore.

4.2 Objektiva në kuadër të mbajtjes nën kontroll të risqeve të portofolit

Objektiv i përgjithshëm

- Reduktimi i kostove për njësi të shërbimit të borxhit publik duke ruajtur raporte të pranueshme të riskut.

Objektiva operacionale

4.2.1 Në kuadër të menaxhimit të riskut të rifinancimit

- Realizimi i financimit të brendshëm në jo më pak se 70% me instrumente afatgjatë, për periudhat kur financimi është në vlera të konsiderueshme (mbi 25 miliardë ALL) dhe 100% me instrumente afatgjata (dhe maturim të instrumenteve afatshkurtra, nëse është e mundur) kur financimi i brendshëm është në vlera të ulëta.

4.2.2 Në kuadër të menaxhimit të riskut të normave të interesit

- Reduktimi i instrumenteve afatshkurtër në portofolin e borxhit të brendshëm deri në 43% të totalit në fund të vitit 2017 dhe deri në 40% në fund të vitit 2019.

- Reduktimi i instrumenteve me norma interesi variabël në portofolin e borxhit deri në 52.5% të totalit në fund të vitit 2017 dhe deri në 51.5 % në fund të vitit 2019.

(Ky raport synohet të arrihet duke e kufizuar shumën e emetimit të obligacioneve me norma interesi variabël në tregun e brendshëm në jo më shumë se 30% të shumës totale të emetimit. Ndërkohë, në tregun e jashtëm përveç kredisë pjesërisht të garantuar nga BB dhe Eurobondit, të cilat janë planifikuar të jenë me norma interesi të fiksuara pjesa tjetër e huave të reja është presupozuar të jetë me norma interesi tregtare dhe të lëvizshme).

4.2.3 Në kuadër të menaxhimit të riskut të kursit të këmbimit

- Mbajtja nën kontroll e borxhit të jashtëm, duke mos tejkaluar 45% e totalit të portofolit të borxhit në fund të periudhës afatmesme 2015-2017.

- Diversifikimi i monedhave në portofolin e borxhit të jashtëm dhe ulja e peshës specifike të monedhës euro, nëpërmjet financimit të projekteve me monedha të përbëra.

Shtimi i rezervës valutore, kryesisht në monedhën euro.

4.2.4 Në kuadër të menaxhimit të riskut të likuiditetit

- Ulja e vlerës së emetimit dhe rishpërndarja e peshave të emetimit, kryesisht në ankandet e bonove të thesarit. (bonove të thesarit 12-mujore të gjysmës së parë të vitit dhe bonove 6-mujore të muajit janar dhe korrik);

- Aplikimi i transaksioneve SWAP dhe Buyback;

- Mbajtja e depozitave me interes në monedhë vendase dhe valutë në Bankën e Shqipërisë.

4.2.5 Në kuadër të menaxhimit të riskut operacional

- Përditësimi i sistemit të regjistrimit të të dhënave (DMFAS);

- Kompozimi ose adaptimi nga Banka Botërore dhe FMN i mjeteve analitike për analizimin e të dhënave të borxhit dhe parashikimin e indikatorëve të riskut;

- Hartimi dhe implementimi i një manuali të detajuar për Drejtorinë e Drejtimit të Borxhit Publik;

- Krijimi i një baze të dhënash e integruar që të përfshijë borxhin e brendshëm dhe të jashtëm;

- Shtimi i kapaciteteve njerëzore nëpërmjet trajnimeve specifike.

- Përmirësime institucionale të Drejtorisë së Borxhit, të cilat mundësojnë rritjen e profilit institucional dhe të profesionalizmit të njësive teknike të administrimit të borxhit.

4.3 Instrumentet financiarë të vlerësuar në periudhën afatmesme 2015-2019

Në kuadër të shërbimit të borxhit ekzistent dhe në kuadër të plotësimit të nevojës për huamarrje Strategjia Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit (SAMB) ka analizuar dhe ka vlerësuar kushtet e tregut të brendshëm dhe të tregjeve ndërkombëtare të kapitalit, duke përcaktuar instrumentet financiarë në dispozicion të vendit tonë.

Në tregun e brendshëm është mbajtur kontakt i vazhdueshëm, kryesisht me sistemin bankar me qëllim evidentimin e kërkesës kundrejt instrumenteve financiarë shtetërorë dhe shkallën e ekspozimit kundrejt instrumenteve me afat të gjatë maturimi.

Ndërkohë, edhe me tregun e jashtëm është mbajtur vazhdimisht kontakt me qëllim



evidentimin e kushteve kundrejt të cilave investitorët e huaj janë të gatshëm të kreditojnë vendin tonë. Në këtë aspekt, dhe me qëllim ndërmjetësimin ndërmjet investitorëve të huaj dhe shtetit shqiptar, një rol të rëndësishëm kanë luajtur edhe partnerët tanë ndërkombëtarë si: Banka Botërore dhe FMN.

Për sa më sipër, SAMB vlerëson se në periudhën afatmesme 2015-2019 shteti shqiptar do të jetë në gjendje që shfrytëzojë alternativat e financimit si më poshtë:

Në tregun vendas

- Bono thesari;
- Obligacione.

Në tregun vendas, likuiditeti i sistemit bankar në nivele të kënaqshme, si edhe perceptimi jo i lartë i riskut të kreditit nga ana e investitorëve, i jep mundësinë shtetit shqiptar të ri-financojë borxhin aktual dhe deficitin e brendshëm nëpërmjet instrumenteve të sipër renditura.

Gjithsesi, gjatë vitit 2015 investitorët kryesorë (sistemi bankar) për shkak të orientimit të bankave mëma, si dhe në kuadër të kufizimeve lidhur me raportet e likuiditetit, barrës së kapitalit dhe ekspozimit ndaj borxhit sovran do të tentojnë më së shumti të orientohen drejt bonove të thesarit.

Në tregjet ndërkombëtare

- Eurobond
- Garanci pjesore e lëshuar nga Banka Botërore (PBG)

Konsiston në garantimin e pjesshëm nga ana e BB-së të një kredie tregtare nga tregjet ndërkombëtare dhe që mundëson një kosto më të favorshme rreth 1 pikë përqindje nën atë të tregut.

- Credit Line/Kredi sindikale

Është një linjë kredie, e cila është vënë në dispozicion të shtetit shqiptar nga ana e disa bankave ndërkombëtare si alternativë në rast dështimi të Eurobondit.

- Kredi për financim projektsh

Në këtë grup futen të gjitha huat në formën e kredive që përdoren për financimin e projekteve, të cilat janë përcaktuar si prioritare nga ana e Qeverisë, me qëllim zhvillimin e mëtejshëm ekonomik të vendit. Kryesisht do të jenë të disponueshme kredi me norma interesi jokoncensionale.

4.4 Kompozimi i strategjive

Strategjia Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit (SAMB), duke marrë në konsideratë objektivat e vendosura, alternativat e financimit në dispozicion të vendit, si edhe çdo eventualitet të mundshëm⁵ në tregun e brendshëm dhe ndërkombëtarë, ka kompozuar strategjinë bazë dhe 3 strategji alternative.

4.4.1 Strategjia 1 (bazë)⁶

Për vitin 2015, strategjia bazë e menaxhimit të borxhit publik, ka marrë në konsideratë faktin që investitorët kryesorë të titujve qeveritarë brenda vendit, që vitin e kaluar kanë dhënë shenja të qarta tërheqje. Gjatë vitit 2015 nga një informacion paraprak prej bankave, mbeten të pambuluara gati 30 mld lekë financim i brendshëm. Duke vlerësuar këtë fakt, si dhe treguesit e rrezikut të rinovimit të shpeshtë të borxhit (rreth 320 mld. lekë rinovohen çdo vit), në vitin 2015 synohet zgjerimi i huamarries në tregun ndërkombëtar për të mbuluar nevojat shtesë për financim dhe nëse krijohet hapësira për të zëvendësuar dhe një pjesë të borxhit afatshkurtër të brendshëm. Gjithashtu, ulja e financimit të brendshëm i shoqëruar me iniciativën e Qeverisë për likuidimin tërësor të detyrimeve të prapambetura do t'i jap mundësinë sektorit bankar për të ristrukturuar portofolin e huas në përputhje të provigjioneve të vendosura nga Konventa Basel III dhe gjithashtu të rrisë dhe mundësinë e kreditimit të sektorit privat.

Kjo do të arrihet nëpërmjet përdorimit të huas së garantuar pjesërisht nga Banka Botërore (*Policy Based Guarantee* - PBG) në një vlerë prej 300 milionë USD (250 milionë euro).

Sipas strategjisë bazë një objektiv i rëndësishëm është edhe rifinancimi i Eurobondit të emetuar në vitin 2010 në vlerën prej 300 milionë euro, nëpërmjet daljes dhe shfrytëzimit të oportuniteteve në tregun ndërkombëtar të instrumenteve financiare. Emetimi i këtij instrumenti me sukses do të ishte një garanci më shumë për sa i përket përmirësimit të strukturës së borxhit dhe në të njëjtën kohë ri-afirmimit të Shqipërisë në tregjet ndërkombëtare të kapitalit.

⁵ Ngjarje në tregun vendas ose të huaj që mund të shkaktojnë mosrealizimin e njërës prej alternativave të financimit të përmendura në seksionin 4.3

⁶ Është përzgjedhur si strategji **bazë** pasi janë analizuar kostot /risqet dhe është krahasuar me strategjitë alternative në seksionet pasardhëse



Financimi i huaj do të realizohet nëpërmjet huave në formën e kredive për realizimin e projekteve prioritare të qeverisë dhe financimit shtesë të akorduar nga FMN dhe Banka Botërore sipas marrëveshjes për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura. Vlera e financimit të huaj do të jetë në përputhje me vlerën e përcaktuar në kuadrin makro-fiskal 2015-2017.

Tabela 3. Financimi i bruto në vlerë relative sipas instrumenteve të financimit

Financimi	Instrumente të financimit	2015	2016	2017
I brendshëm	Bono thesari	60.0%	70%	70.0%
	Obligacione	17.0%	21%	24.0%
	Total	77.0%	91.0%	94.0%
I huaj	Eurobond	8.5%		
	PBG	6.5%		
	Financim i huaj	8.0%	9.0%	6.0%
	Total	23.0%	9.0%	6.0%

Vlerësojmë se skenari bazë ka një probabilitet të lartë ndodhjeje. Gjithsesi, SAMB merr parasysh edhe risqet negative të mosndodhjes së skenarit bazë, të materializuara në strategjitë alternative si më poshtë:

4.4.2 Strategjitë alternative

Strategjia 2

Është konceptuar si skenar alternativ i strategjisë bazë dhe merr në konsideratë dështimin e daljes në tregjet ndërkombëtare të kapitalit për arsye nga më të ndryshmet⁷. Në një skenar të tillë është parashikuar që rifinancimi i Eurobondit ekzistent të realizohet nëpërmjet një linje krediti. Linja e kreditit parashikon një kredi në vlerën e 200-250 milionë euro, me afat maturimi 5 vjet, por në dallim nga Eurobondi supozohet që të jetë me norma më të larta. Pjesa e mbetur për të ri-financuar Eurobondin do të financohet nëpërmjet huas pjesërisht të garantuar nga Banka Botërore.

Një skenar i kësaj natyre do të rriste kostot e shërbimit të borxhit dhe në të njëjtën kohë do të ushtronte më shumë presion në tregun e brendshëm për shkak të rritjes së financimit 7 deri në 14 miliardë lekë.

Strategjia 3

⁷Arsyet e dështimit të Emetimit të Eurobondit mund të jenë të ndryshme, si p.sh mosshfaqje interesi nga investitorët, mbyllje e përkohshme e tregjeve si pasojë e ndonjë krize globale, etj.

Është konceptuar si rasti i skenarit më të keq të mundshëm dhe supozon dështimin e daljes në tregjet ndërkombëtare të kapitalit për rifinancimin e Eurobondit. Njëkohësisht presupozon edhe mos realizimin e huas pjesërisht të garantuar nga Banka Botërore.

Në këtë rast është menduar që rifinancimi i Eurobondit të realizohet nëpërmjet linjës së kreditit në vlerën e 300 milionë euro, ndërkohë që do të kemi një rritje të konsiderueshme në huamarrjen e brendshme në më shumë se 35 miliardë lekë.

Presioni i ushtruar nga rritja e huamarrjes në tregun e brendshëm, si edhe fakti që tregu i brendshëm gjatë vitit 2015 do të jetë më tepër i orientuar drejt instrumenteve afatshkurta bën që kjo strategji të ketë një risk rifinancimi dhe likuiditeti të lartë dhe në të njëjtën kohë të ushtrojë presion rritës mbi normat e interesit të tregut vendas.

Ky skenar vlerësohet të ketë një probabilitet tejet të ulët ndodhjeje, por gjithsesi SAMB merr parasysh dhe është e parapërgatitur edhe në rastet e ndodhjes së skenarëve të tillë ekstrem.

Strategjia 4

Është konceptuar si skenar alternativ i strategjisë bazë dhe merr në konsideratë rastin e mos sigurimit të huas së garantuar pjesërisht nga BB. Në këtë rast me qëllim përmbushjen e objektivit për uljen e presionit të financimit të brendshëm dhe lehtësimin e kreditimit të sektorit privat, është parashikuar që emetimi i Eurobondit të realizohet në vlerën e 500 milionë euro. Kjo është një strategji e cila nga pikëpamja e kostove dhe risqeve është e krahasueshme me strategjinë 2.

4.4.3 Supozimet makroekonomike në periudhën afatmesme

Në këtë nënkapitull paraqiten supozimet kryesore makroekonomike të strategjisë.

Këto supozime janë faktorë kyç dhe ndryshimi i tyre mund të ketë ndikim mbi realizimin e objektivave, mbi kostot dhe kryesisht mbi risqet e strategjisë. Në këtë kontekst, është shumë e rëndësishme që bilanci primar të qëndroj në të njëjtat nivele, ekonomia të stimulohet nëpërmjet konsolidimit të politikave fiskale, uljes së informalitetit, etj; qëndrueshmëria e monedhës të garantohet nëpërmjet politikave monetare të shëndosha dhe rritjes së eksporteve.

Pjesë e supozimeve krahas atyre të ilustruara në tabelën e mëposhtme janë edhe normat e interesit të instrumenteve të tregut të brendshëm dhe atyre të tregut të jashtëm. Projektionet e normave të interesit për tregun vendas janë realizuar duke marrë në konsideratë politikat monetare të Bankës së Shqipërisë dhe riskun e perceptuar nga ana e investitorëve kundrejt instrumenteve financiarë vendas. Ndërkohë, për sa i përket normave të interesit të tregjeve ndërkombëtare janë marrë në konsideratë parashikimet e institucioneve financiarë si: Banka Qendrore Europiane, BB. etj.

Tabela 4. Supozimet makroekonomike

Treguesi	2015	2016	2017	2018
Bilanci primar (në mln. lekë)	(9,028)	8,881	29,416	37,611
PBB (në milion lekë)	1,491,990	1,595,966	1,717,932	1,848,854
EUR/ALL	142.01	143.85	145.68	145.68

4.5 Analiza kosto-risk dhe përzgjedhja e strategjisë bazë

Pas kompozimit të strategjive të mësipërme, të gjitha strategjitë i janë nënshtruar analizës kosto-risk me qëllim evidentimin e kostove dhe risqeve që mbart secila prej tyre.

Në skenarin bazë⁸ Strategjia 1 (bazë) ka rezultuar si strategjia me koston më të ulët për sa i përket shërbimit të borxhit dhe rrjedhimisht edhe nivelit të borxhit të pritshëm në fund të periudhës afatmesme 2015-2019.

Ndërkohë për të evidentuar risqet e asociuara me normat e interesit në tregun vendas dhe të huaj, si dhe riskun e kursit të këmbimit, secila prej strategjive i është nënshtruar skenarëve të stresit.

Skenar stresi 1: 15 % shock mbi kursin e këmbimit⁹;

Skenar stresi 2: 25% shock mbi normat e interesit të tregut vendas;

Skenar stresi 3: 25% shock mbi normat e interesit të tregjeve të huaja;

Skenar stresi 4¹⁰: 10% shock mbi kursin e këmbimit, 25% *shock* mbi normat e tregut vendas dhe të huaj.

Nga testimi i skenarëve të stresit strategjia 1 (bazë) ka rezultuar më pak e ekspozuar në kuadër të shërbimit të borxhit dhe më shumë e ekspozuar, për sa i përket nivelit të borxhit në raport me PBB. Gjithsesi edhe pse mbart risk të konsiderueshëm, për sa i përket nivelit të borxhit, strategjia bazë mbetet më e pranueshme pasi i ofron më shumë hapësirë borxhit vendas për t'u ristrukturuar dhe për të reduktuar risqet që mbart portofoli

Më poshtë paraqiten grafikisht rezultatet e analizës kosto-risk për secilën nga strategjitë.


⁸ I referohet skenarit ku strategjitë janë testuar me supozimet e nënkapitullit 4.4.5.

⁹ Zhvlerësim i monedhës vendase ndaj monedhave të huaja me 15%


¹⁰ Skenar stresi i kombinuar



Kostot dhe risqet e shërbimit të borxhit/PBB



Kostot dhe risqet e nivelit të borxhit/PBB





Për sa më sipër dhe duke marrë në konsideratë instrumentet e financimit në dispozicion të vendit, strategjia bazë është një strategji e cila vjen në përputhje me objektivat kryesore të menaxhimit për përmirësimin e strukturës së borxhit dhe në veçanti të borxhit të brendshëm i cili mbart edhe riskun më të lartë.


4.5.1 Avantazhet e strategjisë bazë

Aplikimi i suksesshëm i strategjisë do të garantonte në fund të vitit 2017 një profil shlyerje që karakterizohet nga një risk rifinancimi më i ulët dhe gjithashtu një përmirësim të riskut të normave të interesit.

Krahasimi i profileve të maturimit Aktual VS strategjia bazë (10 vjet periudhë kohore)



Raporti instrumente me norma fikse/instrumente me norma të ndryshueshme (2014-2018)



Ulja e financimit të brendshëm me rreth 35 miliardë lekë i jep mundësi portfolit të borxhit të brendshëm të ristrukturohet, të krijoj benchmarke të instrumenteve afatgjatë dhe në të njëjtën kohë t'i ofrojë mundësi sistemit bankar të ristrukturojë portfolin në kuadër të ekspozimit ndaj riskut sovran dhe të rrisë shanset e kreditimit të sektorit privat.

4.5.2 Analiza e ndjeshmërisë ndaj risqeve


Rritja e stokut të borxhit të huaj deri në 45% e bën këtë strategji vulnerabël ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit.

Një zhvlerësim i mundshëm i monedhës


vendase kundrejt monedhës euro ose ndaj monedhave të tjera, të cilat janë pjesë përbërëse e portfolit të borxhit do të kishte efekte rritëse mbi raportin e stokut të borxhit ndaj PBB pavarësisht mbajtjes së njëjtë të stokut në vetvete dhe në të njëjtën kohë efekte financiare rritëse që rrjedhin nga shërbimi i borxhit.

Më konkretisht, një zhvlerësim i monedhës vendase prej 15% ndaj të gjitha monedhave që kompozojnë portfolin e borxhit të jashtëm do e rriste nivelin e borxhit me rreth 4.1 pikë përqindje dhe në të njëjtën kohë shërbimin e borxhit deri në 12 pikë bazë.

Ndjeshmëria e nivelit të borxhit në raport me PBB ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit



Ndjeshmëria e shërbimit të borxhit në raport me PBB ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit




Nga ana tjetër, rritja e ekspozimit të borxhit ndaj monedhës së huaj mund të rrisë ndjeshmërinë ndaj faktorëve të jashtëm duke ndikuar në uljen e qëndrueshmërisë së borxhit dhe si rrjedhojë të shoqërohet me një ulje në vlerësimin e kreditit nga kompanitë e vlerësimit. Një ulje në vlerësim do të shkaktonte rritje të kostos së huamarrjes së jashtme dhe njëkohësisht rritje të nivelit të borxhit.


Një risk tjetër i cili ka efekte të konsiderueshme mbi nivelin dhe kryesisht mbi shërbimin e borxhit është edhe risku i normave të interesit të tregut të brendshëm dhe atij të huaj.

Rritja e normave të interesit në tregun vendas dhe atë të huaj me 25% do të kishte efektet të cilat ilustrohen grafikisht si më poshtë:

Ndjeshmëria e shërbimit të borxhit në raport me PBB ndaj luhatjeve të normave të interesit



Ndjeshmëria e nivelit të borxhit në raport me PBB ndaj luhatjeve të normave të interesit




Strategjia Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit duhet theksuar se gjithashtu ka një ndjeshmëri të konsiderueshme në përmbushjen e objektivave të saj edhe ndaj faktorit rritje ekonomike.

Mosrealizimi i rritjes ekonomike sipas supozimeve afatmesme do të kishte efekte të konsiderueshme mbi nivelin e borxhit, i cili është

dhe një nga objektivat primar jo vetëm të menaxhimit të borxhit, por edhe i qeverisë.

Në analizë është supozuar impakti i një rënie të PBB nominale me 1%.

Ndjeshmëria e nivelit të borxhit në raport me PBB ndaj luhatjes së PBB



Nga analiza rezulton se rënia e PBB nominale me 1% ka efekt të moderuar mbi nivelin e borxhit. Gjithsesi, duhet marrë në konsideratë se në realitet rënia ekonomike shoqërohet me rënie të të ardhurave në buxhetin e shtetit, si edhe jep ndikim edhe mbi tregues të tjerë makro-fiskal, të cilët kanë efekt në zgjerimin e deficitit primar duke bërë që të rritet nevoja për huamarrje. Për sa më sipër, impakti i një rënie të PBB është i një shkalle më të konsiderueshme nga ajo që paraqitet grafikisht.

4.5.3 Qëndrueshmëria e borxhit në periudhën afatmesme

Qëndrueshmëria e borxhit publik në periudhën afatmesme është një element shumë i rëndësishëm, i cili është i lidhur ngushtë me përmirësimin e politikave të menaxhimit të borxhit dhe likuiditetit. Nga ana tjetër, qëndrueshmëria e borxhit do parë jo vetëm në këndvështrimin e menaxhimit të detyrimeve, por edhe në menaxhimin e aseteve në mënyrë që të ketë një harmonizim ndërmjet jetëgjatësisë së aseteve dhe detyrimeve.

Është shumë e rëndësishme që nga ana e Qeverisë të ndërmerren reforma me qëllim rritjen e aseteve dhe konsolidimin e treguesve makroekonomik me qëllim uljen e ndjeshmërisë së tyre ndaj risqeve. Në këtë kontekst, Strategjia e Menaxhimit të Borxhit sugjeron marrjen e masave të mëposhtme:

Në kuadër të rritjes së të ardhurave


- Konsolidimi makro-fiskal;
- Reforma në kuadër të luftës kundër informalitetit;
- Reforma e pensioneve;
- Reforma në fushën e drejtësisë dhe në kuadër të luftës kundër korrupsionit.

Në kuadër të përmirësimit të treguesve makroekonomik dhe ndjeshmërisë nga jashtë


- Rritja e rezervës valutore;
- Rritja e eksporteve dhe përmirësimi i bilancit tregtar nëpërmjet politikave të stimulimit të sektorëve që kanë avantazhe konkurruese dhe krahasuese.

Treguesit e qëndrueshmërisë së borxhit

- Ndër treguesit kryesorë të qëndrueshmërisë së borxhit është treguesi i raportit të borxhit në raport me të ardhurat¹¹, i cili shpreh aftësinë ripaguese të qeverisë.





Brenda të njëjtit kontekst është edhe treguesi i shërbimit të borxhit në raport me të ardhurat.



¹¹ Për vendet në zhvillim, ky tregues preferohet të jetë nën 250%

Borxhi i jashtëm në raport me eksportet dhe rezervat valutore



4.5.4 Parashikimi i treguesve të riskut

Implementimi i strategjisë bazë në përputhje me supozimet e bëra në skenarin bazë, në fund të vitit 2017 do të rezultonte me treguesit e mëposhtëm të riskut:

Objektivat e riskut	Treguesi	Vlera			Rëndësia e objektivit
		2014	2015	2017	
Risku i rifinancimit	DMM (në vite)				
	Borxhi i brendshëm	1.80	1.78	1.76	E lartë
	Borxhi i jashtëm	7.52	7.91	7.38	
	Borxhi total	4.11	4.5	4.28	
	Maturime brenda 1 viti				
	Borxhi i brendshëm	59.18%	59.40%	56.40%	E lartë
	Borxhi i jashtëm	16.92%	5.45%	5.98%	
	Borxhi total	41.74%	35.36%	33.92%	
Risku i normave të interesit	KMR				
	Borxhi i brendshëm	1.62	1.63	1.68	E lartë
	Borxhi i jashtëm	4.48	4.61	3.47	
	Borxhi total	2.80	2.95	2.47	
	Borxhi i rifiksuar në 1 vit				
	Borxhi i brendshëm	72.11%	70.81%	65.30%	E lartë
	Borxhi i jashtëm	56.75%	46.68%	54.20%	
	Borxhi total	65.80%	60.05%	60.36%	
	Instrumenta fiks/total				
	Borxhi i brendshëm	37.70%	40.90%	46.40%	E lartë
	Borxhi i jashtëm	56.77%	55.80%	48.80%	
	Borxhi total	45.57%	47.55%	47.50%	
Riksu i kursit të këmbimit	Borxhi në valut/totalit	41.26%	44.55%	44.60%	E lartë

**VENDIM****Nr. 192, datë 4.3.2015****PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE
DHE KRITEREVE PËR
PËRZGJEDHJEN E PROJEKTEVE,
ORGANIZATAVE APO EVENTEVE NGA
BORDI I ÇËSHTJEVE TË MIRA TË
LOTARISË KOMBËTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “c”, të pikës 18.3, të marrëveshjes së licencës për Lotarinë Kombëtare, ndërmjet Ministrisë së Financave, si autoritet i autorizuar, dhe shoqërisë “Oesterreichische Lotterien”, GmbH, nëpërmjet shoqërisë “OLG Project”, sh.p.k., miratuar me ligjin nr. 95/2013, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**I. PARIME TË PËRGJITHSHME**

1. Ky vendim ka për qëllim përcaktimin e procedurave dhe kriterëve për përzgjedhjen e projekteve, organizatave apo eventeve nga Bordi i Çështjeve të Mira të Lotarisë Kombëtare, me qëllim përdorimin sa më të efektshëm të fondit të caktuar për t'u përdorur për çështjet e mira.

2. Fjalët dhe shprehjet e përdorura në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim me atë të dhënë në marrëveshjen e licencës së Lotarisë Kombëtare (Marrëveshja), të miratuar me ligjin nr. 95/2013, “Për miratimin e marrëveshjes së licencës për Lotarinë Kombëtare, ndërmjet Ministrisë së Financave, si autoritet i autorizuar, dhe shoqërisë “Oesterreichische Lotterien”, GmbH, nëpërmjet shoqërisë “OLG Project”, sh.p.k”, në ligjin nr. 10033, datë 11.12.2008, “Për lojërat e fatit”, të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, në përputhje me kontekstin e dhënë në to, përveç rasteve kur përcaktohet shprehimisht ndryshe.

II. BORDI I ÇËSHTJEVE TË MIRA

3. Bordi i Çështjeve të Mira (në vijim “Bordi”) përbëhet nga 3 përfaqësues të të licencuarit për ushtrimin e aktivitetit të Lotarisë Kombëtare (në vijim “I licencuari”) dhe 4 përfaqësues të Ministrisë së Financave.

4. Emërimi i përfaqësuesve të Ministrisë së Financave bëhet me urdhër të ministrit të Financave, brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

5. Caktimi i anëtarëve të të licencuarit bëhet nga ky i fundit dhe i bëhet i ditur zyrtarisht ministrit të Financave, brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

6. Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, Bordi, me kërkesë të ministrit të Financave, bën mbledhjen e konstituimit të tij, si dhe zgjedh kryetarin dhe sekretarin e Bordit.

7. Kryetari i Bordit zgjidhet nga radhët e përfaqësuesve të emëruar nga ministri i Financave, ndërsa sekretari i Bordit emërohet nga i licencuari.

8. Bordi, në mbledhjen e dytë, miraton rregulloren e funksionimit të tij, me të cilën rregullohen çështjet që kanë të bëjnë me mënyrën e lajmërimit të mbledhjeve, verifikimin e pjesëmarrjes së nevojshme për vlefshmërinë e mbledhjeve apo të vendimeve, shumicën e nevojshme për të marrë vendime, mënyrën e mbajtjes e të ruajtjes së procesverbaleve të mbledhjes, vendin e organizimit të mbledhjeve, detyrat e sekretarit, si dhe çdo çështje tjetër që ka të bëjë me mirëfunksionimin e Bordit.

9. Pagesa e kryetarit, anëtarëve të Bordit, sekretarit, si dhe mbulimi i shpenzimeve që bëhen për shkak të funksionimit të Bordit përballohen nga i licencuari.

Për punën e kryer në Bordin e Çështjeve të Mira:

a) kryetari merr një shpërblim, në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj;

b) anëtarët marrin një shpërblim, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj;

c) sekretari merr një shpërblim, në masën 5 000 (pesë mijë) lekë në muaj.

Shpërblimi paguhet vetëm për pjesëmarrësit në mbledhje, të dokumentuar me procesverbal. Pjesëmarrësit duhet të marrin pjesë rregullisht në mbledhje, me përjashtim të rasteve kur mungesa është e justifikuar. Nëse gjatë një muaji nuk zhvillohet asnjë mbledhje, shpërblimi për atë muaj nuk paguhet. Për pjesëmarrje të rregullt në mbledhje, kryetari, anëtarët e Bordit, dhe sekretari nuk mund të paguhën me më shumë se 12 shpërblime në vit.

10. Projektet fituese financohen nga kontributi i derdhur nga i licencuari në bazë të marrëveshjes, i cili është 2.2% (dy pikë dy për qind) e xhiros vjetore të të licencuarit (Fondi i



çështjeve të mira). Ky kontribut përbën një pagesë të detyrueshme në çdo vit financiar për të licencuarin, i cili do ta paguajë, jo më vonë se data 15 shkurt e vitit pasardhës financiar, në llogarinë bankare, e cila i njoftohet të licencuarit nga Ministria e Financave.

Të ardhurat e përfutuara në llogarinë bankare, sipas paragrafit të parë, monitorohen nga struktura përgjegjëse e Ministrisë së Financave dhe konsiderohen si të ardhura jashtë limitit për vitin korrent buxhetor. Të ardhurat e papërdorura të “Fondit për çështjet e mira” në fund të vitit buxhetor mbarten në buxhetin e vitit pasardhës.

“Fondi i çështjeve të mira” nuk financon projekte, evente apo organizata, të cilat financohen nga linja të tjera të buxhetit dhe që krijojnë mbivendosje.

Financimi i projektpropozimit, kur aplikuesi është institucion publik buxhetor ose institucion që financohet nga buxheti i shtetit, regjistrohet për institucionin si e ardhur jashtë limitit, me të drejtë mbartjeje në vitin pasardhës. Përdorimi i këtyre të ardhurave bëhet me autorizim nga ministri i Financave, pas rritjes së autorizuar të të ardhurave.

11. Vendimet e Bordit janë të detyrueshme për t’u zbatuar nga të gjitha strukturat dhe personat e ngarkuar me mbajtjen e llogarisë së “Fondit të çështjeve të mira”.

III. KRITERET PËR PËRZGJEDHJEN E PROJEKTEVE, ORGANIZATAVE APO EVENTEVE FITUESE DHE MËNYRËS SË SHPËRNDARJES SË FONDIT

12. Gjatë procesit të shqyrtimit dhe përzgjedhjes së subjekteve përfituese (aplikuesve) dhe të financimit të projekteve, organizatave apo eventeve nga Bordi i Çështjeve të Mira respektohen dhe garantohen:

- a) liria e pjesëmarrjes dhe e konkurrimit;
- b) mosdiskriminimi dhe trajtimi i barabartë;
- c) transparenca e procedurave të vendimmarrjes, duke u ofruar të gjithë aplikuesve të dhënat dhe procedurën përkatëse;
- ç) mungesa e prapaveprimit, duke përjashtuar mundësinë e shpërndarjes së fondeve për veprimtari tashmë të realizuara në datën e vendimmarrjes;

d) paanshmëria e shqyrtimit të vendimmarrjes dhe parandalimi i konfliktit të interesave;

dh) përjashtimi i mbivendosjes, që nënkupton shmangien e financimit të së njëjtës veprimtari për të njëjtin interes konkret, më shumë se një herë, gjatë një viti fiskal.

13. Brenda muajit mars të çdo viti, Bordi shpall njoftimin për pjesëmarrje në një procedurë konkurrimi, në faqen e internetit të Ministrisë së Financave, si autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e lojërave të fatit dhe të të licencuarit. Bordi shpall në faqen zyrtare të institucioneve të sipërpërmendura udhëzimet për njoftimin për pjesëmarrje, formularin e aplikimit, formularin e buxhetit, kriteret për përzgjedhjen e aplikuesve fitues, një listë të plotë të dokumenteve të nevojshme për t’u paraqitur dhe një kontratë tip. Në faqen zyrtare pasqyrohen pyetjet sqaruese të bëra nga aplikantët, si dhe përgjigjet e dhëna, nëse ka.

14. Bordi duhet të përcaktojë dhe të përfshijë në njoftimin për pjesëmarrje afatin e dorëzimit të projektpropozimeve. Ky afat nuk mund të jetë më i vogël se 30 (tridhjetë) ditë pune nga data e botimit të njoftimit. Bordi ka të drejtë të zgjatë afatin e paraqitjes së projektpropozimit, deri në momentin e përfundimit të afatit të dorëzimit të projektpropozimeve. Afati i ri publikohet në faqen zyrtare të internetit, sipas pikës 13, të këtij vendimi. Në këtë rast, afati i dorëzimit të projektpropozimeve shtyhet jo më shumë se 10 (dhjetë) ditë pune.

15. Aplikuesit, institucionet publike, buxhetore apo jobuxhetore, persona fizikë apo juridikë jobuxhetorë, që janë regjistruar sipas ligjit dhe kryejnë veprimtari në përputhje me qëllimin e përcaktuar në statutin e tyre, kanë të drejtë të aplikojnë, të konkurrojnë dhe të paraqesin projektpropozimet e tyre.

16. Institucionet publike, buxhetore apo jobuxhetore, duhet të paraqesin për shqyrtim pranë Bordit projektpropozimin dhe çdo dokument shtesë që mund të kërkojë Bordi.

17. Aplikuesit, personat fizikë ose juridikë jobuxhetorë, së bashku me projektpropozimin duhet të paraqesin edhe dokumentet e mëposhtme kur aplikojnë për të përfutur të drejtën e financimit nga “Fondi i çështjeve të mira”:

a) Vendimin e gjykatës së rrethit gjyqësor për regjistrimin e aplikuesit ose ekstraktin e regjistrimit në QKR;



b) Një dokument që vërteton se aplikuesi nuk është në ndjekje penale dhe nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë;

c) Një dokument që vërteton se aplikanti nuk është në proces falimentimi dhe/ose likuidimi;

ç) Kopje të pasqyrave financiare për tri vitet e fundit, të audituara dhe të depozituara në organet tatimore;

d) Një dokument që vërteton se aplikuesi ka paguar rregullisht sigurimet shoqërore për stafin e punësuar;

dh) Një dokument që vërteton se aplikuesi nuk ka detyrime tatimore, të lëshuar nga organet tatimore;

e) Licencën/lejen për ushtrim veprimtarie, vetëm në rastet kur aktiviteti/ veprimtarinë e kërkuara për t'u financuar nuk mund të kryhen sipas ligjit, pa zotëruar një licencë të dhënë nga autoritetet publike;

ë) Dokumentacionin e nevojshëm (relacione, referenca), të cilat kërkohen nga Bordi apo organet e tij në shqyrtimin e projektpropozimit.

Dokumentacioni i parashikuar në shkronjat “a” deri në “ë”, të kësaj pike, duhet të jetë në origjinal ose kopje e noterizuar dhe të jetë lëshuar brenda 3 (tre) muajve nga data e aplikimit.

Në çdo rast, Bordi mund të kërkojë dokumentacion shtesë, të nevojshëm për vlerësimin e projektpropozimit.

Nuk mund të konkurrojnë partitë politike, sindikatat, institucionet fetare dhe organizatat politike. Aplikuesit, të cilët kanë projekt në proces të mbështetur nga Bordi, nuk kanë të drejtë të aplikojnë përpara përfundimit dhe paraqitjes së raportit final të këtij projekti.

18. Bordi ofron:

a) fonde për periudha afatshkurtra deri në 1 (një) vit fiskal;

b) fonde për periudha afatgjata deri në 3 (tri) vite fiskale.

Fondet afatgjata u jepen aplikuesve për projektpropozime, zbatimi i të cilave parashikon një kohëzgjatje deri në 3 (tre) vjet.

19. Vlerësimi mbështetet në përputhjen e projektpropozimit të paraqitur nga aplikuesi në procedurat e konkurrimit me qëllimin e organizatës/aplikuesit dhe programin që zbaton, kapacitetet e aplikuesit, efektshmërinë e aktiviteteve, pritshmërinë dhe koston e tyre.

20. Projektpropozimet e paraqitura zbatohen në territorin e Republikës së Shqipërisë.

21. Për çdo konkurrim, Bordi ofron një kalendar kohor të procesit të përzgjedhjes, ku përfshihen afati i fundit për aplikimin e projektpropozimeve, afati i fundit për vlerësimin e tyre, data e pritshme për nënshkrimin e kontratës dhe koha e pritshme për fillimin e projektit.

22. Anëtar i bordit nuk mund të votojë ose të marrë pjesë në vendimmarrje kur ai, bashkëshorti ose bashkëshortja, i biri ose e bija, i afërmi, në vijë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, me lidhje gjaku ose krushqie, deri në shkallë të dytë, ka interes financiar ose në çështjet që lidhen me një person juridik, kur ai është anëtar, merr pjesë në administrimin e tij ose ka interes financiar në të, sipas ligjit.

23. Procedura e përzgjedhjes së projektpropozimit përfshin fazat e mëposhtme:

a) Botimin e planit vjetor të veprimit në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Financave, si autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e lojërave të fatit dhe të të licencuarit;

b) Njoftimin paraprak dhe botimin në faqen zyrtare të çdo procedure konkurrimi;

c) Vënien në dispozicion të dokumenteve përkatëse të konkurrimit;

ç) Ndryshimet dhe sqarimet e bëra gjatë procedurës;

d) Dorëzimin e projektpropozimit dhe regjistrimin e aplikuesve pjesëmarrës nga bordi;

dh) Shqyrtimin e pranueshmërisë së plotësisë së aftësive teknike e financiare e të regjistrimit dhe vlerësimin e projektpropozimit;

e) Njoftimin e rezultateve të konkurrimit, përfshirë kushtet për përshtatje ose ndryshime;

ë) Në rast refuzimi të të gjithë aplikuesve, deklaratën dhe arsyet e këtij refuzimi;

f) Negociimin e mundshëm për ndryshimet e përcaktuara, si kusht për miratimin e projektpropozimit fitues;

g) Negociimin dhe nënshkrimin e kontratës;

gj) Botimin e informacionit në faqen zyrtare të internetit.

24. Vendimmarrja për financimet për projekte, organizata apo evente realizohet, si më poshtë vijon:

a) Çdo anëtar i Bordit shqyrton çdo projektpropozim dhe jep vlerësimin e tij pas një diskutimi të përbashkët.



b) Bordi merr vendimin përkatës, me shumicë votash, për projektet që do të financohen, duke konsideruar standardet dhe objektivat, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve pune nga data e mbylljes së procedurës së aplikimit.

c) Bordi, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e marrjes së vendimit, ua njofton vendimin të gjitha subjekteve aplikuese.

25. Çdo subjekt përfitues nënshkruan një kontratë me kryetarin e Bordit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune nga data e përfundimit të vlerësimit të rezultateve të konkurrimit. Në kontratë përcaktohen kushtet e përgjithshme dhe specifike, duke përfshirë, por pa u kufizuar në sasinë e fondit të marrë, dhe aktivitetet për t'u ndërmarrë. Projektet e shpallura fituese, organizatat apo eventet, si edhe vlera e miratuar për projektet dhe mënyra e shpërndarjes së kësaj vlere do të bëhen publike në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave si edhe në faqen zyrtare të të licencuarit.

26. Propozimet fituese do të marrin fillimisht 50% të fondit të miratuar, 40 % pas paraqitjes së raportimit afatmesëm dhe 10% e fondit të miratuar jepet pas miratimit të raportit final. Për projekte afatgjata, këto shifra do të zbatohen për buxhetin vjetor respektiv. Në çdo rast, financimi do të bëhet me vendim të Bordit dhe me miratimin e ministrit të Financave.

27. Në rastin e mospërmblidhjes së aktiviteteve të projektit apo kryerjes së shpenzimeve që nuk kanë qenë të lejuara, pjesa respektive e buxhetit i kthehet Ministrisë së Financave dhe do të jetë pjesë e "Fondit të çështjeve të mira" në raundin e ardhshëm të njoftimit për pjesëmarrje. Për ndryshime mbi 15% në linjat buxhetore është i nevojshëm një miratim paraprak i Bordit.

28. I Licencuari do të krijojë një njësi të veçantë në strukturën e tij, e cila merret me monitorimin e projekteve të financuara dhe raportimin para Bordit sipas periudhave, si më poshtë vijon:

a) Për projektet me afat më të shkurtër se 1 (një) vit, raportet financiare dhe teknike paraqiten dy herë në përfundim të gjysmës së parë të projektit (afatmesëm) dhe në fund të projektit (final).

b) Për projektet që zgjasin më shumë se 1 (një) vit, raportet për vitin e dytë dhe më tej paraqiten çdo 6 (gjashtë) muaj.

29. Njoftimi për pjesëmarrje në një procedurë konkurrimi, sipas pikës 13, vetëm për vitin 2015, do të jetë brenda muajit prill.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 193, datë 4.3.2015

**PËR SHPALLJEN E ZONËS
EKONOMIKE, ME STATUSIN "ZONË E
LIRË", NË SPITALLË 2, DURRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 9789, datë 19.7.2007, "Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike", me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen e zonës ekonomike, me statusin "Zonë e lirë", të territorit me sipërfaqe 22 ha, pjesë e zonës kadastrale nr. 8517, në përbërje të së cilës janë parcelat me nr. pasurie 148/6 dhe nr. 149/1, në Spitallë 2, Durrës.

2. Shtrirja dhe kufizimet e kësaj zone përcaktohen në hartën treguese, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Lloji i veprimtarisë, që do të zhvillohet në këtë zonë, është:

- veprimtari prodhuese, përpunimi dhe agropërpunim;
- veprimtari tregtare, import-eksport;
- shërbime dhe magazinim mallrash;
- veprimtari ndihmëse.

4. Periudha e funksionimit të zonës është 35 vjet.

5. Procedura e përzgjedhjes së zhvilluesit të zonës së lirë të bëhet në zbatim të rregullave dhe procedurave konkurruese, të përcaktuara në ligjin nr. 125/2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", të ndryshuar.


6. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletore Zyrtare

KRYEMINISTRI
Edi Rama



RILEVIM TOPOGRAFIK
i prones se "Ferra" Sh.p.k.(Spitalle, Durrës)
Shkalla 1 : 2500



SHENIME TEKNIKE:

- MATJET U KRYEN ME GPS "TOPCON POWER PLUS"
- SAKTESIA NE MATJEN E PIKAVE DETAJE ESHTJE +/- 9MM
- PERMASAT NE KETE MATERIAL SHPREHIN
- GJATESINE NE METRA NGA ANA E JASHTME E MURIT
- (PRA MURI ESHTJE PERFSHIRE NE SIPERFAQEN E PRONES)
- KANALI NUK ESHTJE PERFSHIRE NE 2 SIPERFAQET
- SIPERFAQJA E KANALIT ESHTJE 4080 M2

POROSITES : "FERRA" SH.P.K.	
PUNOI: STUDIO TOPOGRAFIKE "GEOMATICA" SH.P.K.	
NUMRI I LICENCES 45007/3	KY MATERIAL U PREGATIT ME
DATE 05.04.2015	DATE 25.01.2015
DREJTUES TEKNIK: ING.DIPL-JAK SULA	CEL:+355 69 20 73392
	E-MAIL: jaksuli@yahoo.com
	WEB: www.geomatica.al

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel: 042427005, 04 2427006